REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 15385 Vendimit

15385

## V E N D I M
## PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me daten 10/04/1996 une Gjyqtare Meni Gjun... e Gjykates se Rrethit Tiranes mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit Kostandin Gjata, Anesti Foto dhe Sotir Lolo per regjistrimin si person juridik te shoqerise Tregetare "TREG-TUR-KORCA" ... dhe

## K O N S T A T O V A

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi Konstandin Gjata, Anesti Foto dhe Sotir Lolo per regjistrimin si person juridik te Shoqerise Tregetare "TREG-TUR-KORCA" SHPK me administrator Anesti Foto, me kapital fillestar 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me seli ne Korce ne magazinat e pazarit, me objekt te veprimtarise ne fushen e tregetimit me shumice e pakice dhe transport i artikujve industriale, ushqimore, fruto-perime, prodhime mishi etj. import-eksport. Aktivitet hotelerie dhe turizem.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7667 date 20.1.1993 dhe te ligjit 7638 date 19.11.1992

## V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te Shoqerise Tregetare "TREG-TUR-KORCA" ShPK me tre ortake kerkuesit Kostendin Gjata, Anesti Foto dhe Sotir Lolo, me administrator Z. Anesti Foto, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me seli ne Korce tek magazinat e pazarit, me kapital fillestar 100.000 leke, me objekt te veprimtarise ne fushen tregetim me shumice e pakice dhe transport i artikujve industriale, ushqimore, fruto-perime, produkte mishi etj. import-eksport. Aktivitet hotelerie dhe turizem.

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkallen e dyte.

GJYQTARE
Meni Gjun

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr Vendimit

# V E N D I M
## I GJYQTYRIT TE VETEM

Ne Tirane sot me daten 4.02.97 une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane Anila Copo mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Anesti Foto, administrator i Shoqerise "TREG-TUR KORCA" ShPK Korce, per depozitimin e akteve te shitjes se kapitalit themeltar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane dhe

## K O N S T A T O V A

Se me vendimin Nr 15385 date 10.7.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar Shoqeria Tregetare "TREG-TUR-KORCA" ShPK.

Me vendimin e dates 1 Shkurt 1997 te asamblese se ortakeve eshte vendosur shitja e pjeseve te ortakeve Anesti Foto dhe Sotir Lolo tek ortaku tjeter i shoqerise Kostandin Gjata, i cili ne kete menyre behet Ortak i Vetem i kesaj shoqerie. Lidhur me transferimin e kapitaleve themeltare te dy ortakeve tek ortaku i vetem, eshte perpiluar edhe kontrata e shitblerjes e dates 1 Shkurt 1997.

Me vendimin e dates 1 Shkurt 1997 te asamblese se ortakeve eshte vendosur qe si administrator i shoqerise te jete Kostandin Gjata.

Kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7667 date 28.I.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992

## V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane te akteve te shitjes dhe vendimit te asamblese se ortakeve te dates 1 Shkurt 1997 te Shoqerise "TREG-TUR-KORCA" ShPK.

Urdherohet zyra e Regjistrit Tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kollonon 3 germa 6. dhe ndarja te behet me vize te kuqe nga njeri tjetri.

GJYQTARE
Anila Copo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me daten 6.05.97 une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane Anila Copo mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Kostandin Gjata, administrator i Shoqerise "TREG-TUR-Korca"ShPK Korce, per depozitimin e akteve te shitjes te kapitalit themeltar dhe ndryshimin e emrit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane dhe

KONSTATOVA

Se me vendimin Nr 15385 date 10.7.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar Shoqeria Tregetare "TREG-TUR-KORCA"ShPK Korce.

Me vendimin Nr 15385/1 date 4.2.1997 jane depozituar ne regjistrin tregetar aktet e shitjes se ortakeve Anesti Foto dhe Sotir Lolo tek ortaku tjeter Kostandin Gjata, i cili mbeti Ortak i vetem i shoqerise

Ne daten 2 Maj 1997 Ortaku i Vetem ka vendosur ndryshimin e emertimit te shoqerise, duke e quajtur "Costa Fruit"ShPK Korce si dhe lejimin e shitjes se 50% te kapitalit themeltar te shoqerise shtetasit grek Cakuridhis Kostas, ku me kontraten e shitblerjes te dates 5 Maj 1997 eshte kryer edhe veprimi juridik i tjetersimit. Ne kete menyre shoqeria do te kete dy ortake, ndersa si administrator i shoqerise mbetet Kostandin Gjata.

Kjo kerkese eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit 7667 date 28.I.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane te akteve te shitjes dhe vendimit te Ortakut te Vetem date 2 Maj 1997 per ndryshimin e emrit te shoqerise.

Urdherohet zyra e Regjistrit Tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen 2 germa c dhe ndarja te behet me vize te kuqe nga njeri tjetri.

GJYQTARE
Anila Copo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
TIRANE
Nr______Vendimi 15385/3

# VENDIM
# I GJYQTARIT TË VETËM

Në Tiranë, sot më datën 23-1-2002 unë ________, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi Kostandin GJATA, dhe

KONSTATOVA

Se, me vendim nr. 15385 datë 10. 07. 1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Shoqëria "COSTA FRUIT" Sh.p.k. është regjistruar për të ushtruar aktivitet tregtar sipas objektit të veprimtarisë.

Me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë datë 24 Dhjetor 2001 është vendosur:

*1. Miratimi i transferimit të kuotave të kapitalit ndërmjet ortakëve CAKURIDHIS Kostas tek ortaku Kostandin GJATA me 50% të kapitalit.*

*2. Ortaku i vetëm i Shoqërisë mbetet Zoti Kostandin GJATA, i cili zotëron 100% të kapitalit.*

*3. Miratimi i ndryshimit të emërtimit të Shoqërisë nga "COSTA FRUIT" Sh.p.k. në "TREG TUR KORÇA" Sh.p.k.*

Kërkesa e paraqitur është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARËSYE:

Në bazë të ligjit 7638 datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregatre" dhe ligjit 7667 datë 28. 01. 1993 "Për Regjistrin Tregtar"

VENDOSA

I. Pranimin e kërkesës.

II. Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë datë 24 Dhjetor 2001 në të cilin është vendosur:

*1. Miratimi i transferimit të kuotave të kapitalit ndërmjet ortakëve CAKURIDHIS Kostas tek ortaku Kostandin GJATA me 50% të kapitalit.*

*2. Ortaku i vetëm i Shoqërisë mbetet Zoti Kostandin GJATA, i cili zotëron 100% të kapitalit.*

*3. Miratimi i ndryshimit të emërtimit të Shoqërisë nga "COSTA FRUIT" Sh.p.k. në "TREG TUR KORÇA" Sh.p.k.*

III. Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit për të bërë ndryshimet në regjistër në kollonat përkatëse duke i ndarë ato me vijë të kuqe.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim.

23-1-2002

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
TIRANE
Nr/15385/Vendimi

# VENDIM
# I GJYQTARIT TË VETËM

Në Tiranë, sot më datën 25/1/ 2002, unë M. Doga, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi Kostandin GJATA, dhe

KONSTATOVA

Se, me vendim nr. 15385 datë 10. 07. 1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Shoqëria "TREG-TUR-KORÇA" Sh.p.k. është regjistruar për të ushtruar aktivitet tregtar sipas objektit të veprimtarisë.

Me vendimin e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë Nr. 4 datë 24. 01. 2002 është vendosur:
*Të fillojnë procedurat për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, dukebërë vlerësimin sipas kërkesave ligjore për kapitalet në natyrë të krijuara gjatë viteve, kërkesë konform nenit 42 të ligjit 7638 datë 19. 11. 1992 "Për shoqëritë tregtare".*
*Për efekt të zmadhimit të kapitaleve të shoqërisë ngarkojmë me mision ligjor të shprehet për këtë qëllim Z. Dhimitër Pano ekspert kontabël i autorizuar, i cili ka dhe marrëveshjen e mandatin e emëruar për 6 vite nga kjo shoqëri.*
*Dega e financës, të vërë në dispozicion të ekspertit kontabël të autorizuar dokumentacionin e kërkuar sipas bilancit, investimet e kryera, invenatret e aktiviteteve të qëndrueshme, vlerësimet e kryera etj., mbi bazën e të cilave ai do të paraqesë para asamblesë Raportin e ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit themeltar.*
*Mbas miratimit përkatës ligjor të ndiqen procedurat ligjore e juridike për depozitimin e tyre në Zyrën e Regjistrit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë brenda muajit.*
*Shpenzimet për ekspertin e avokatin sipas kontratës e faturës do të bëhen nga ana e shoqërisë.*

Kërkesa e paraqitur është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARËSYE:

Në bazë të ligjit 7638 datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregatre" dhe ligjit 7667 datë 28. 01. 1993 "Për Regjistrin Tregtar"

VENDOSA

I. Pranimin e kërkesës.

II. Depozitimin e Vendimit të Ortakut të Vetëm të shoqërisë Nr. 4 datë 24. 01. 2002 në të cilin është vendosur:

1. *Të fillojnë procedurat për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, dukebërë vlerësimin sipas kërkesave ligjore për kapitalet në natyrë të krijuara gjatë viteve, kërkesë konform nenit 42 të ligjit 7638 datë 19. 11. 1992 "Për shoqëritë tregtare".*

2. *Për efekt të zmadhimit të kapitaleve të shoqërisë ngarkojmë me mision ligjor të shprehet për këtë qëllim Z. Dhimitër Pano ekspert kontabël i autorizuar, i cili ka dhe marrëveshjen e mandatin e emëruar për 6 vite nga kjo shoqëri.*
3. *Dega e financës, të vërë në dispozicion të ekspertit kontabël të autorizuar dokumentacionin e kërkuar sipas bilancit, investimet e kryera, invenatret e aktiviteteve të qëndrueshme, vlerësimet e kryera etj., mbi bazën e të cilave ai do të paraqesë para asamblesë Raportin e ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit themeltar.*

III. Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit për të bërë ndryshimin në regjistër në kollonën përkatëse duke e ndarë atë me vijë të kuqe.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE
Majlinda Doffo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
TIRANE
Nr 15385/3 Vendimi

# VENDIM
# I GJYQTARIT TË VETËM

Në Tiranë, sot më datën 30/1/ 2002, unë M. Dogo, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi Kostandin GJATA, dhe

KONSTATOVA

Se, me vendim nr. 15385 datë 10. 07. 1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Shoqëria "TREG-TUR-KORÇA" Sh.p.k. është regjistruar për të ushtruar aktivitet tregtar sipas objektit të veprimtarisë.

Me vendimin e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë Nr. 5 datë 27. 01. 2002 është vendosur:

1. *Miratimi i raportit të ekspertit për kontributet të datës 26. 01. 2002 lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë në vlerën 133 984 854 lekë, nëpërmjet kontributit në natyrë sipas zërave të evidentuara në pasqyrën bashkëngjitur raportit. Kësaj vlere të kapitalit i shtohet vlera pre 100 000 lekë e derdhur për themelimin e shoqërisë dhe gjithësej vlera arrin në shumën 134 084 854 lekë.*
2. *Neni 2 i Aktit të Themelimit ndryshon si vijon: Vlera e kapitalit themeltar do të jetë prej 134 084 854 lekë, kontribut i ortakut të vetëm Z. Kostandin Gjata.*

Kërkesa e paraqitur është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARËSYE:

Në bazë të ligjit 7638 datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregatre" dhe ligjit 7667 datë 28. 01. 1993 "Për Regjistrin Tregtar"

VENDOSA

I. Pranimin e kërkesës.

II. Depozitimin e Vendimit të Ortakut të Vetëm të shoqërisë Nr. 5 datë 27. 01. 2002 në të cilin është vendosur:

1. *Miratimi i raportit të ekspertit për kontributet të datës 26. 01. 2002 lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë në vlerën 133 984 854 lekë, nëpërmjet kontributit në natyrë sipas zërave të evidentuara në pasqyrën bashkëngjitur raportit. Kësaj vlere të kapitalit i shtohet vlera pre 100 000 lekë e derdhur për themelimin e shoqërisë dhe gjithësej vlera arrin në shumën 134 084 854 lekë.*
2. *Neni 2 i Aktit të Themelimit ndryshon si vijon: Vlera e kapitalit themeltar do të jetë prej 134 084 854 lekë, kontribut i ortakut të vetëm Z. Kostandin Gjata.*

III. Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit për të bërë ndryshimin në regjistër në kollonën përkatëse duke e ndarë atë me vijë të kuqe.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE
Majlinda Dogo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 15385/6 VENDIMI

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot ne dt. 28/5/ 2003, une,gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, M. Dogje mbasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori i Shoqerise "Treg Tur Korçë" shpk, Z.Kostandin Gjata

KONSTATOVA

Me vendimin Nr. 15385 dt. 10.07.1996 te Gjykates se shkalles se pare Tirane eshte regjistruar Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emeruar " Treg Tur Korcë" SHPK me seli ne Korce, me kapital themeltar 100.000 leke

Me vendimin 13385/5,dt.30.01.2002 te Gjykates se shkalles se pare Tirane eshte bere rritja e kapitalit ne shumen 134084854 leke.

Shoqeria " Treg Tur Korcë" SHPK qe nga momenti i krijimit dhe deri me sot ka zgjeruar aktivitetin e saj dhe per rrjedhoje, kapitali i saj eshte zmadhuar.

Me vendimin nr. 6,dt. 20.04.2003, te ortakut te vetem te Shoqerise " Treg Tur Korcë" SHPK eshte vendosur caktimi i ekspertit kontabel te autorizuar Z. Dhimiter Pano per te bere zmadhimin e kapitalit themeltar me ane te kontributeve ne natyre. Ne kete kuader persa me lart dhe bazuar ne ligjet ne fuqi vendosa te emroj ekspertin

1. Z.Dhimiter Pano ekspert kontabel i autorizuar

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7667,dt. 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar"

VENDOSA:

Depozitimin e vendimit nr. 6,dt. 20.04.2003, te ortakut te vetem te Shoqerise " Treg Tur Korcë" SHPK per emrimin e ekspertit kontabel te autorizuar Z.Dhimiter Pano per vleresimin e kontributeve ne natyre qe do te futen ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Aktet e mesiperme te depozitohen prane regjistrit Tregtar, duke bere ndryshimet perkatese.

GJYQTARE
Majlinda Dogje

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS PARË**
**T I R A N Ë**
**Nr.** 15386/7 **VENDIMI**

**V E N D I M**
**I GJYQTARIT TË VETËM**

Une Gjyqtar/e e Gjykates se Shkallës Parë Tiranë [signature], sot më datë 01.07.2003, pasi u njoha me kërkesën e paraqitur nga Administratori i Shoqërisë Tregtare "Treg Tur Korcë" SHPK z. Kostandin Gjata i cili kërkon depozitimin e Vendimit Nr. 7 dt. 16.06.2003 të Ortakut të Vetëm pranë Rregjistrit Tregtar për zmadhim kapitali me kontribute në natyrë,

**K O N S T A T O V A**

***Se me vendimin Nr.15385 dt. 10.07.1996 te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë*** është rregjistruar si person juridik prane rregjistrit Tregetar te kesaj Gjykate shoqeria tregtare "Treg Tur Korca" SHPK me kapital themeltar 100.000 lek.
***Me Vendimin Nr. 15385/5 dt. 30.01.2002*** të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë është bërë zmadhimi i kapitalit themeltar në shumën e 134084854 lekë e me ortak të vetëm z. Kostandin Gjata.

**Me Vendimin Nr. 15385/6 dt. 28.05.2003 të Gjykatës Shkallës Parë Tiranë** është bërë depozitimi i Vendimit nr. 6 dt. 20.04.2003 të Ortakut të Vetëm të shoqërisë me të cilin është vendosur fillimi i procedurave për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me anën e kontributeve në natyrë si dhe caktimi i një eksperti kontabël të autorizuar, z. Dhimitraq Pano, për vlerësimin e kontributeve në natyrë.

***Me Vendimin Nr. 7 dt. 16.06.2003 të Ortakut të Vetëm*** të shoqërisë është vendosur miratimi i Raportit të ekspertit kontabël të autorizuar z. Dhimitraq Pano i dt. 12.06.2003 ku kontributi në natyrë me të cilin do të zmadhohet kalpitali themeltar është vlerësuar në shumën e 10627652 lekë. Së bashku me kapitalin themeltar të mëparshëm prej 134084854 lekë me zmadhimin e kapitalit ai arrin në shumën e 144712506 lekë.
Po me këtë vendim janë vendosur dhe ndryshimet në aktin e themelimit dhe Statutit( Nenit 2) si vijon : "Vlera e kapitalit themeltar do të jetë prej 144712506 lekë dhe me ortak të vetëm z. Kostandin Gjata".

Mbështetur në Vendimin Nr. 7 dt. 16.06..2003 të Ortakut të Vetëm dhe në Raportin e ekspertit të cilët i plotësojnë kushtet e parashikuara nga legjislacioni tregtar kërkesa është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

***PER KETO ARSYE***

Ne baze te ligjit Nr. 7632 dt.04.11.1992; Ligjit Nr. 7638 dt.19.11.1992 dhe ne Ligjin Nr. 7667 dt. 28.01.1993

***VENDOSA***

Pranimin e kërkesës.
Depozitimin e Vendimit Nr. 7 dt. 16.06.2003 të Ortakut të Vetëm dhe të Raportit dt. 12.06.2003 të vlerësimit të kontributeve në natyrë të ekspertit z. Dhimitraq Pano pranë Rregjistrit Tregtar, sipas të cilëve kapitali themeltar i shoqërisë është zmadhuar me kontribute në natyrë të vlerësuara në shumën e 10627652 lekë dhe së bashku me kapitalim themeltar të mëparshëm arrin në shumën e 144712506 lekë.
Urdherohet Zyra e Rregjistrit Tregtar te beje shënimet përkatëse në Rregjistrin Tregtar.
Kundër vendimit mund të bëhet ankim.

**GJYQTAR/E**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 15385/8 VENDIMI

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot ne dt. 18.02. 2005, une,gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, M. Lumo mbasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga ortakut te Shoqerise "TREG-TUR-KORCA " sh.p.k, z. Kostandin Gjata

KONSTATOVA

Me vendimin Nr. 15385 dt. 10.07.1996 te Gjykates se shkalles se pare Tirane eshte regjistruar Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emeruar "TREG-TUR-KORCA shpk me seli ne Korce me kapital themeltar 100.000 leke

Shoqeria "TREG-TUR-KORCA " SHPK qe nga momenti i krijimit dhe deri me sot ka zgjeruar aktivitetin e saj dhe per rrjedhoje, kapitali i saj eshte zmadhuar.

Me vendimin nr. 8 dt. 10.02.2005, te ortakut te Shoqerise " TREG-TUR-KORCA " SH.P.K. eshte vendosur caktimi i ekspertit Z. Dhimiter Pano me detyre ekspert kontabel i autorizuar per te bere zmadhimin e kapitalit themeltar me ane te kontributeve ne natyre. Ne kete kuader persa me lart dhe bazuar ne ligjet ne fuqi vendosa te emroj ekspertin

1. Z.Dhimiter Pano ekspert kontabel te shoqerise

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7667,dt. 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar"

VENDOSA:

Depozitimin e vendimit nr. 8,dt. 10.02.2005, te ortakeve te Shoqerise "TREG-TUR-KORCA " shpk per emrimin e ekspertit kontabel te autorizuar Z.Dhimiter Pano per vleresimin e kontributeve ne natyre qe do te futen ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Aktet e mesiperme te depozitohen prane regjistrit Tregtar, duke bere ndryshimet perkatese.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 15385/9 VENDIMI

# V E N D I M
## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot ne dt. 07-07. 2005, une,gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mbasi shqyrtova kerkesen per ndreqjen e gabimit te paraqitur nga ortaku i Shoqerise "Treg Tur Korca " sh.p.k, z. Kostandin Gjata

## K O N S T A T O V A

Me vendimin Nr. 15383 dt. 10.07.1996 te Gjykates se shkalles se pare Tirane eshte regjistruar Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emeruar "Treg Tur Korca " shpk me seli ne Korce me kapital 100.000 leke

Me vendimin nr. 8 dt. 10.02.2005, te ortakut te Shoqerise eshte vendosur caktimi i ekspertit Z. Dhimiter Pano me detyre ekspert kontabel i autorizuar per te filluar procedurat per shndrimin e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime. Gabimisht ne vendimin e gjykates eshte shenuar caktimi i ekspertit per te bere zmadhimin e kapitalit themeltar me anen e kontributeve ne natyre . Ne kete kuader persa me lart dhe bazuar ne ligjet ne fuqi kerkojme qe te behet ndreqja e ketij gabimi duke u shenuar fillimi i procedurave per shendrimin e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7667,dt. 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar"

## V E N D O S A:

Ndreqen e gabimit ne vendimit nr. 15385/8 dt. 18.02.2005 te depozituar prane regjistrit tregtar persa i perket dispozitivit te ketij vendimi ku . Gabimisht ne kete vendimin eshte shenuar caktimi i ekspertit per te bere zmadhimin e kapitalit themeltar me anen e kontributeve ne natyre , duke u korigjuar me fillimi e procedurave per shendrimin e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime.

Aktet e mesiperme te depozitohen prane regjistrit Tregtar, duke bere ndryshimet perkatese.

G J Y Q T A R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 15385/10 Vendimi

# VENDIM
# I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane,sot me date 05.10 2005,une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, M. [illegible] ,mora ne shqyrtim Kerkesen dhe aktet e paraqitura nga kerkuesi Kostandin Gjata,ortak i Vetem i shoqerise''Treg Tur Korca''Shpk,dhe

## KONSTATOVA

Se shoqeria''Treg Tur Korca''shpk eshte regjistruar si person juridik me Vendimin nr.15383 date 10.07.1996 te Gjykates se Shkalles se PareTirane. Me vendimin nr.8 dt.18.02.2005 dhe nr.9 date 07.07.2005 te ortakut te Vetem te shoqerise eshte vendosur;

-Caktimi i ekspertit kontabel z.Dhimitraq Pano per shnderimin e Shoqerise ''Treg Tur Korca''shpk nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime.

Me vendimin nr.10 dt.08.07.2005 te ortakut te vetem te shoqerise eshte vendosur;

Miratimi i raportit te ekspertit kontabel te autorizuar per transfomimin e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kuizuar ne shoqeri anonime.

- Miratimin e statutit dhe aktit te themelimit te ri.
- Miratimin keshillit mbikqyres te perbere nga;

| | |
|---|---|
| Kostandin Gjata | -Kryetar i Keshillit Mbikqyres. |
| Kristaq Gjata | -Zv/kryetar |
| Meleq Nano | - Antar |

Drejtor administrativ i shoqerise caktohet z, Ibrahim Golloberda.
Kerkohet depozitimi i vendimit nr.10 date 08.07.2005 Ortakut te Vetem te Shoqerise 'TREG TUR KORCA'SH.PK
Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te ligjit 7638 date 19.11.1992''Per Shoqerine Tregetare''
Dhe ligjit 7667 date 28.01.1993''Per Regjistrim Tregetar''.

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin e vendimit nr.10 date 08.07.2005 ortakut te vetem te Shoqerise'' TREG TUR KORCA''sh.pk,per miratimin e raportit te Ekspertit kontabel te autorizuar per transformimin e shoqerise nga ''Treg Tur Korca''shpk ne ''Treg Tur Korca''sh.a

- Miratimin e statutit dhe aktit te themelimit te ri.
- Miratimin e keshillit mbikqyres te perbere nga;
  Kostandin Gjata -Kryetar i Keshillit Mbikqyres
  Kristaq Gjata -Zv/kryetar
  Meleq Nano - Antar
  Drejtor administrtativ caktohet z. Ibrahim Golloberda
  Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne Skeden e shoqerise duke i ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te Kuqe.

GJYQTARE

15385

Vendimi i regjistrimit

(1) Shoqëri "Treg-Tur Korça"

(2) Korçë (në magazinat pazar)

(3) Kryhen me shumicë e pakicë të artikujve industrialë, ushqimë, fruta-perime etj

(4) 100.000 lekë nr 5551/2620/00
dt 10/06/1996
B. Kursimeve Korçë

(5) Kostandin Gjata
Anesti Koto
Sotir Lolo

(6) 10 vjet

(7) Statuti 12 fletë dt 9/07/1996

Gjyqtare
Mentor Gjini

**AKT THEMELIMI**

**E SHOQERISE "TREG-TUR-KORCA" SH P K**

**ME SELI NE QYTETIN E KORCES**

Sot me daten 1 Korrik 1996 ne Korce shtetasit:

1- Kostandin Kristaq Gjata, datelindje 1965, me banim Bul. "Republika", P.1, Shk. C/6 Korce.

2- Anesti Kosta Foto, datelindja 1963, me banim Rr"Rexhep Telhaj", P.10, Shk. A/8 Korce.

3- Sotir Koco Lolo, datelindja 1955, me banim Rr"Pano Xhamballo", P.21, Shk. A/6 Korce.

ne marreveshje midis tyre vendosen te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "TREG-TUR-KORCA", me seli ne qytetin e Korces, e cila do te funksionoje sipas kesaj kontrate dhe statutit bashkangjitur kontrates si dhe ligjit 7512 date 10.8.1991 dhe ligjit Nr 7638 date 19.11.1992.

DISPOZITAT BAZE TE THEMELIMIT

Neni 1

Themelohet ne Korce Shoqeria e quajtur "TREG-TUR-KORCA" SH P K Korce.

Qendra e saj ndodhet ne qytetin e Korces me adrese: Magazinat tek pazari i qytetit Korce.

Shoqeria mund te krijoje dege e agjensi edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

Neni 2

Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe veprimtaria e saj do te zhvillohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fushen e prodhimit, tregetimit, doganore, tatimore dhe ne gjithe veprimtarine juridiko-civile.

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Tregetim me shumice e pakice dhe transport i artikujve industriale, ushqimore, fruta-perime, prodikte mishi etj. import-eksport. Aktivitet hotelerie dhe turizem. Shoqeria ne te ardhmen mund te zgjeroje aktivitetin e saj edhe ne fusha te tjera.

Neni 4

Veprimtaria e shoqerise do te zgjase mbi 10 vjet, duke u lejuar mundesia e zgjatjes se ketij afati me pelqimin e ortakeve themelues. Veprimtaria do te filloje mbas regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 5 Kapitali themelues i shoqerise eshte 100 000 leke ehe ndodhet i depozituar ne Banken Tregetare te Shqiperise dega Korce.Kapitali ne natyre do te vleresohet ne castin e fillimit te veprimtarise nga nje ekspert i autorizuar.Proces verbali i vleresimit te kapitalit ne natyre do te bashkangjitet me kontraten dhe statutin dhe eshte pjese perberese e kontrates.

Kapitali eshte i ndare sipas ortakeve ne keto raporte:

1. Kostandin Cjata 33,333%
2. Anesti Foto 33,333%
3. Sotir Lolo 33,333%

Neni 6

Ortaket mbajne pergjegjesi per shkeljet e fajshme qe kane sjelle deme ne veprimtarine ekonomoke-financiare te shoqerise.

Ortaket perballojne humbjet deri ne masen e kapitalit te investuar ne shoqeri.

Neni 7

Fitimi i realizuar nga shoqeria do te ndahet ne raport me perqindjen e kapitalit te investuar nga sejcili ortak.

Fitimi do te ndahet midis ortakeve themelues,mbasi te shlyhen te gjitha detyrimet qe ka shoaeria ndaj organeve fiskale,doganore, tatimore,administrative dhe ndaj te treteve.

Neni 8

Mbas regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar,ajo do te paraqitet ne qarkullimin civil tregetar,mbasi te paiset me lejen per ushtrim profesioni.

Afati i veprimtarise mbaron me plotesimin e kohes se parashikuar ne kontrate.Ortaket mund te zgjatin afatin e veprimtarise se shoqerise ose mund te heqin dore sipas kushteve te lejuara nga statuti para perfundimit te afatit.

Neni 9

Veprimtaria ekonomike-financiare e shoqerise si dhe investimet e saj,ne baze te ligjes,do te gezojne mbrojtjen nga shteti,i cili krijon edhe kushtet per ushtrimin e veprimtarise si per te gjithe personat juridike.

Neni 10

Detyrimet e ortakeve jane :

- Regjistrimi dhe marrja e lejes per fillimin e veprimtarise.
- Mundesia e fillimit te aktivitetit prodhues tregetar.
- Sigurimi i makinerive e paisjeve,i lendeve te para e materialeve per ushtrimin e veprimtarise.

- Sigurimi i fuqise puntore e personelit tekniko-administrativ.
- Sigurimi i rrjetit elektrik e inxhinerik te nevojshem per objektet e shoqerise.
- Derdhja e kapitalit fillestar ne llogarine e shoqerise ne afatin ligjor.
- Gjetja e tregut per shitjen e artikujve.
- Gjetja e tregjeve per furnizimin me lendet e para e materialet.
- Pjesmarrja aktive ne veprimtarine e shoqerise.

Neni 11

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve.
- [illegible] nje administrator **i vetem** qe eshte **Anesti Foto.**
- Ekspertet kontabel.

Neni 12

Ortaket,si dhe te punesuarit ne shoqeri,jane te detyruar te ruajne sekretin e krijimit,te veprimtarise si dhe ato fakte,qe jane te destinuara te mbeten sekret,te shoqerise.Ata mbajne pergjegjesi ne rastet kur vertetohet se i jane shkaktuar deme shoqerise nga mosrespektimi me dashje ose nga pakujdesia i kesaj dispozite.

Neni 13

Ne rastet kur ortaku heq dore nga shoqeria para perfundimit te afatit,mban pergjegjesi per shkaktimin e demit shoqerise dhe detyrohet ti shlyeje ato.Masa dhe menyra e percaktimit te fajesise dhe e shlyerjes se demit eshte ajo e percaktuar ne dispozitat e Kodit Civil,te ligjes "Mbi shoqerite tregetare" dhe legjislacionit ne fuqi.

Neni 14

Mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me pajtim brenda shoqerise,zgjidhen nga gjykata.Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve,eshte Gjykata e Rrethit Korce.

Neni 15

Kjo kontrate themelimi u hartua ne kater kopje te barazvlefshme dhe legalizohet para noterit te vendit ku ka qendren shoqeria.

ORTAKET THEMELUES

Anesti Foto — Sotir Lolo — Kostandin Grata

# S T A T U T

## I SHOQERISE "TREG-TUR-KORCA" SH P K

## KORCE

Sot me daten 1 Korrik 1996 ortaket themelues :

1- Kostandin Gjata,i dtlindjes 1965,banues ne Korce.

2- Anesti Foto,i datelindjes 1963,banues ne Korce.

3- Sotir Lolo,i datelindjes 1955,banues ne Korce.

te shoqerise "TRE-TUR-KORCA" SH P K Korce redaktuan kete statut sipas te cilit,ortaket kane rene dakort, do te funksionoje shoqeria. Statuti eshte i ndare ne shtate kapituj dhe eshte perpiluar sipas dispozitave te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare"

### I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria me emrin "TREG-TUR-KORCA" rregullon poziten juridike te themeluesve,te organeve drejtuese te saj,marredheniet me punesuarit si dhe personat e trete ne pajtim me ligjin 7512 date 10.8.1991,ligjin 7638 date 19.11.1992,Kodin e Punes dhe legjislacionin ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria ka qendren e vet ne qytetin e Korces ne adresen e percaktuar ne kontraten e themelimit.Ajo mund te krijoje dege e agjensi te tjera ne rrethe te tjera te Shqiperise.

Neni 3

Shoqeria eshte shoqeri shqiptare dhe ka statusin e personit juridik shqiptar.

Neni 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj: Tregetim me shumice e pakice dhe transport i artikujve industriale,ushqimore, fruta-perime,prodhime mishi etj. import-eksport.Aktivitet hotelerie dhe turizem.Shoqeria ne te ardhmen mund te zgjeroje aktivitetin e saj edhe ne fusha te tjera.

Neni 5

Shoqeria pergjigjet per detyrimet qe krijon ne veprimtarine e saj me fondet e veta.Kur keto jane te pamjaftueshme,ortaket mun te vendosin shtimin e kapitalit deri ne masen qe mbulohen humbjet

Neni 6

Shoqeria per nevojat e veprimtarise se saj nuk pengohet te marre nga cilado Banke,qe vepron ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj kredi ne kushtet e lejuara nga legjislacioni shqipatr.

Neni 7

Ortaket nuk pengohen te marrin pjese ne shoqeri te tjera dhe te krijojne te drejta pronesie personalisht ose me persona te tjere

Neni 8

Shoqeria eshte "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar",ku sejcil nga ortaket perballon humbjet deri ne masen e kapitalit themelues te investuar.Shoqeria perbri emertimit te saj shenon edhe inicialet "SHPK".

Ne kushtet e lejuara nga nenet 73 dhe 77 te ligjit "Per shoqe rite tregetare",shoqeria mund te shnderohet ne shoqeri kolektive,ko-manndite dhe anonime.

Neni 9

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaket,qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 10

Ne konsultimet ose ne mbledhjet e asamblese vendimet merren nga nje ose disa ortake,qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapi-talit theletar.

Ne rast se kjo shume nuk arrihet,ortaket thirren per here te dyte dhe vendimet merren me shumicen e votave te dhena,pavaresisht nga perqindja e kapitalit qe ato perfaqesojne.

Neni 11

Ne rastet kur pjesa e kapitalit te njerit prej ortakeve,per shkak te detyrimeve personale te tij,i kalon nje ose disa personave te tjere,keta te fundit nuk mund te behen ortake te shoqerise pa pelqimin unanim te ortakeve te tjere.Ne rast se ky pelqim nuk jepe pjesa e kapitalit qe ka humbur ish ortaku,mund te blihet prej orta-keve te tjere.

Neni 12

Heqja dore nga shoqeria e ortakeve themelues,lejohet kur at konstatojne se ortaket e tjere me ndergjegje kryejne veprime qe de tojne interesat e shoqerise ose te ortakeve ne vecanti,ose kur ver tetohet se organet perfaqesuese jane te paafta per drejtimin e saj

Ortaku qe heq dore,lajmeron nje vit perpara per kete veprim me shkrim organet drejtuese.

Heqja dore nuk e liron ortakun nga detyrimet qe shoqeria ka krijuar deri ne momentin e heqjes dore,dhe nuk e pengon te kerkoje perfitimet qe vijne nga veprimtaria e shoqerise.

Neni 13

Me vdekjen e nje ortaku shoqeria prishet,por ajo mund te vazhdoje aktivitetin,mbasi te vendoset me unanimitet prej ortakeve qe mbeten gjalle dhe trashegimtareve te ortakut te vdekur.

Necoftese trashegimtaret nuk deshirojne te hyjne ne shoqeri ose jane te paafte per kete,vazhdueshmeria e shoqerise mund te vendoset me unanimitet nga ortaket e gjalle,me kusht qe ata te blejne te drejtat mbi shoqerine te perfshira ne trashegimine e ortakut te vdekur.

Neni 14

Shitja e pasurise,mbi te cilen eshte pronare shoqeria,tek personat e tjere nga njeri prej ortakeve,lejohet mbasi ortaket e tjere kane cfaqur me shkrim mendimin e tyre se nuk pranojne blerjen e saj.Shitja e pjeses se ortakut behet me po ate cmim qe i propozohet ortakeve te tjere,ndryshe eshte e pavlefshme.

Neni 15

Emetimi i letrave me vlere,subvencionimi i tyre ose garantimi i letrave te emetuara prej shoqerise eshte e ndaluar.

Cdo marreveshje tjeter ne kundershtim me kete dispozite eshte e pavlefshme.

Neni 16

Shoqeria prishet ne rast falimentimi,privimi i te drejtes se ortakeve per te ushtruar kete veprimtari ose profesionin tregetar, si dhe ne rastin e paaftesise se njerit prej ortakeve.Ne rastin e paaftesise se njerit prej ortakeve,shoqeria mund te mos prishet,ne se ortaket e tjere vendosin me unanimitet vazhdueshmerine e saj, mbasi te kene pranuar kushtin e riblerjes se te drejtave mbi shoqerine prej ortakut qe eshte bere i paafte.

II. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 17

Ortaket i gezojne te drejtat e tyre nepermjet vendimeve qe merr Asambleja e ortakeve.Ata kane keto te drejta kryesore:

- Administrojne teresisht veprimtarine prodhuese,tregetuese dhe ekonomike-financiare te shoqerise.

- Marrin ne cdo faze te veprimtarise dijeni mbi gjendjen e kapitalit dhe llogarive ekonomike te shoqerise.

- Marrin pjese vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre,ne operacionet prodhuese e tregetare te shoqerise.

- Terheqin ne cdo kohe dokumentacionin kryesor te shoqerise,si raportin e administrimit,inventaret e ndryshem dhe llogarite tremujore e vjetore per tre vjetet e fundit.

- Kerkojne shpegime per cdo material te paraqitur ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve,ose kontrollojne dokumentat e nevojshme shoqeruese te materialit te paraqitur.

- Merr nga administratori,15 dite para mbledhjes,raportin e administrimit dhe projektin e vendimeve qe do te shqyrtoje mbledhja e Asamblese se Ortakeve.

- Kontrollon cdo aktivitet prodhues e tregetues vete ose me nje ekspert kontabel.

- Nje ose disa ortake qe perfaqesojne jo me pak se 10% te kapitalit themeltar,kane te drejte te kerkojne mbledhjen e Asamblese.

- Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime,duke disponuar nje numur votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

- Nje ortak mund te perfaqesohet ne marrjen e vendimeve nga nje ortak tjeter,ne baze te autorizimit te leshuar prej tij.Po keshtu ai mund te perfaqesohet edhe nga ndonje person tjeter te autorizuar prej tij.

- Ortaku jo administrator ka te drejte t'i paraqese me shkrim dy here ne vit,administratorit disa pyetje per probleme qe vene ne dyshim vazhdueshmerine e veprimtarise se shoqerise.

- Nje ose disa ortake qe perfaqesojne jo me pak se 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar,mund te kerkojne ne rruge gjyqesore,caktimin e nje ose disa eksperteve te ngarkuar per paraqitjen e nje raporti per nje ose disa veprime administrative.

- Ortaket jane te pavarur ne marrjen e vendimeve dhe cfaqjen e vendimeve per problemet qe shqyrtohen.

- Heqin dore nga shoqeria ne kushtet e parashikuara nga kontrata e themelimit dhe statuti.

Neni 18

Ortaket kane keto detyrime kryesore:

- Depozitojne brenda afatit te kerkuar kapitalin themelor ne te holla,ose vene ne disponim te shoqerise kapitalin ne natyre sipas kontrates se themelimit.

- Paguajne,kur eshte rasti,kuoten sup...

detyrimeve te shoqerise,deri ne masen e vendosur nga Asambleja,per te perballuar humbjet.

- Percaktojne organet perfaqesuese dhe ekspertet kontabel ne rast mosmarreveshjesh.

- Marrin pjese ne mbledhjet e Asamblese personalisht ose me ane perfaqesuesi.

- Plotesojne detyrimet e shoqerise ndaj te treteve solidarisht.

- Informojne organet drejtuese mbi mundesite e permiresimit e zhvillimit te veprimtarise prodhuese e tregetuese.

- Jep kontribut konkret me sherbime dhe ploteson detyrat konkrete,qe i ngarkohen.

## III. KUSHTET EKONOMIKE

Neni 19

Kapitali i shoqerise ne leke eshte 100 000 leke dhe ndodhet i depozituar ne Banken Tregetare te Shqiperise dega Korce.

Pjesa e kapitalit te sejcilit ortak eshte pasqyruar ne kontraten e themelimit.

Administratori i pajis ortaket me dokumentin e derdhjes se kuotes se kapitalit themelor ne leke.

Neni 20

Pasurite ne natyre te shoqerise do te vleresohen ne momentin e fillimit te veprimtarise me ekspertet qe do te emerojne ortaket. Mbas ketij vleresimi,ortaket nuk kane te drejte te kerkojne rivleresimin e tyre.

Shoqeria mund te blere ne Republiken e Shqiperise pasuri te tjera me te ardhurat e saj,te cilat mund t'i disponoje sipas miratimit te Asamblese se Ortakeve.

Neni 21

Pasurite e shoqerise vleresohen ne bilancet e saj me vlere te shprehur ne monedhe te vendit ose monedhe te huaj,e cila konvertohet sipas marreveshjes se ortakeve ne momentin e vleresimit.

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes.Forma e tij percaktohet nga administratori i shoqerise,sipas miratimit te Ministrise se Financave ne Republiken e Shqiperise.

Neni 22

Kapitali i sejcilit prej ortakeve eshte lirisht i transferueshem tek ortaket e tjere,tek trashegimtaret ligjore,tek bashkeshorti me rastin e zgjidhjes se marteses,tek paraardhesit e pasardhesit ne kushtet e kerkuara nga ligji mbi trashegimine.Pjeset e kapitalit

themeltar mund te transferohen vetem me pelqimin e te gjithe ortakeve.

Subjektet qe perfitojne nga transferimi detyrohen te disponojne kapitalin e perfituar per nevojat e shoqerise per periudhen nje vjecare,duke perfituar te gjitha te drejtat qe kishte mbajtesi i kapitalit.

Cdo transferim do te evidencohet me shkrim.Me transferimin behen ndryshimet perkatese ne statut dhe shenimet ne regjistrin tregetar.

Neni 23

Kapitali themelor mund te disponohet edhe tek te tretet ne kushtet e caktuara ne kontraten e themelimit dhe ne dispozitat e ketij statuti.

Kapitali qe tjetersohet vleresohet me marreveshje nga ortaket,dhe kur kjo nuk eshte e mundur,nga nje ekspert i caktuar prej tyre.

Neni 24

Kapitali fillestar i shoqerise zvogelohet ose zmadhohet me miratim te Asamblese se Ortakeve.

Zmadhimi i kapitalit ne para ose ne natyre behet si ne rastin e kapitalit themeltar ne momentin e krijimit te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit fillestar mund te vendoset me kusht qe te preke ne te njejtin perpjestim te gjithe ortaket.Projekti i zvogelimit u vihet ne dispozicion ortakeve jo me vone se 30 dite para mbledhjes se Asamblese se Ortakeve.Zvogelimi i kapitalit lejohet vetem ne rastet kur nuk krijon pasiguri tek kreditoret dhe nuk demton interesat e tyre lidhur me kredite e dhena para publikimit te zvogelimit te kapitalit.

Ndryshimet ne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit shenohen ne statut.

Neni 25

Shoqeria krijon fondet e financimit te saj si dhe fondin rezerve,per te perballuar nevojat qe mund t'i paraqiten.

Ajo disponon lirisht mjetet e saj financiare.Detyrimet qe mund te krijohen i shlyen me fondin rezerve ose fondet e tjera.Kur keto fonde jane te pamjaftueshme,mund te zmadhoje kapitalin themelor deri ne plotesimin e detyrimeve ndaj te treteve,mbas miratimit nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 26

Ne rast se kapitali i shoqerise rezulton me pak se gjysma e kapitalit themeltar,per shkak te humbjeve,ortaket vendosin zvogelimin e kapitalit themelor,ose ne rast te kuncert,prishjen e parakohshme te shoqerise.

Neni 27

Fitimi i shoqerise,ce rezulton mbasi zbritet bilanci negativ i saj,ndahet midis ortakeve ne raport me kapitalin themeltar te investuar prej tyre.

Pjesa e fitimit te sejcilit ortak eshte lirisht e transferueshme jashte Republikes se Shqiperise.

Fitimi mund te perdoret edhe per investime te tjera ne Shqiperi,per pjesmarrje ne shoqeri te tjera dhe per cdo qellim qe cmohet nga sejcili ortak.

Neni 28

Plani financiar parashikon aktivin dhe pasivin e aktivitetit ekonomik te shoqerise te shprehur ne leke ose ne valute te huaj, sipas marreveshjes se ortakeve,te konvertueshme ne Shqiperi.

Llogaria kontabel do te mbahet ne Shqiperi si dhe ne cdo vend tjeter ku ortaket do te vendosin ne mbledhjen e pare te Asamblese se Ortakeve.

Shnderrimi i monedhes shqiptare me monedhe te huaj dhe anasjelltas,do te behet sipas kursit zyrtar ose privat si ne Bankat Shqiptare apo te huaja,edhe ne tregun e lire.

## IV. A D M I N I S T R I M I

Neni 29

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve,e cila vendos me dy te tretat e votave per te gjitha ceshtjet qe merr ne shqyrtim,kur ne dispozita te vecanta ligjore ose te ketij Statuti nuk eshte vendosur ndryshe.

Asambleja e Ortakeve perbehet prej ortakeve themelues,te cilet kane te drejte vote ne perpjestim me madhesine e kapitalit te depozituar ne shoqeri.

Asambleja mblidhet te pakten kater here ne vit ne mbledhje te rregullta(cdo tremujor),duke lajmeruar 15 dite me pare nga administratori.

Neni 30

Mbledhja e ortakeve mund te thirret edhe me inisiativen e ortakut qe ka pjesen me te vogel ne kapitalin e shoqerise,duke cak-

tuar nje mandat mbajtes,i cili kryen te gjitha veprimet e nevojshme per thirrjen e mbledhjes dhe caktimin e rendit te dites.

Per ceshtjet qe shqyrtohen,sejcili ortak ka te drejte te kerkoje ndihme nga ekspert kontabel,i cili detyrohet te ruaje sekretin profesional.

Te gjitha ceshtjet qe shqyrtohen ne mbledhjen e asamblese se ortakeve,pasqyrohen ne proces verbalin e saj,i cili qendron gjithmone ne seline e shoqerise.

Neni 31

Asambleja e Ortakeve shqyrton te gjitha ceshtjet me te rendesishme qe kane te bejne me mbarevajtjen e shoqerise si,bilancin vjetor e tremujor,ndryshimet ne statut,shtimin ose zvogelimin e kapitalit themelor,emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,percaktimin e drejtimeve kryesore te veprimtarise se shoqerise ne cdo periudhe te vitit,krijimin e filialeve,te degeve ose agjensive dhe shkrirjen ose mbylljen e aktivitetit dhe caktimin e likuidatorit.

Neni 32

Shoqeria do te administrohet nga Z. **Anesti Foto.** i cili perfaqeson shoqerine ne te gjithe veprimtarine e saj.

Administratori ka keto kompetenca :

- Miraton llogarite ekonomike mbas perfundimit te tyre nga administrata.
- Pergatit raportin vjetor per veprimtarine e shoqerise dhe ja paraqet Asamblese se Ortakeve.
- Siguron zbatimin e vendimeve qe merr mbledhja e ortakeve.
- Paraqet para Asamblese se ortakeve propozimet konkrete per ndryshimin e kapitalit themelor.
- Propozon ne Asamblene e Ortakeve mundesine e krijimit te filialeve,degeve dhe zyrave te nevojshme per veprimtarine e shoqerise.
- Propozon krijimin e organeve te tjera per permiresimin e punes se shoqerise.
- Paraqet ne Asamble ose miraton akte qe rregullojne marredhenie me kuadrin ose te punesuarit.
- Perzgjedh e propozon ne Asamblene e Ortakeve eksperte kontabel e likuidatorin.
- Percakton numurin e pergjithshem te puntoreve e percakton pagat e tyre.
- Pergatit per Asamblene e ortakeve raportin e pushimit te veprimtarise se shoqerise.
- Perfaqeson shoqerine ne organet administrative,gjyqesore,doganore,fiskale e ato te pushtetit dhe zgjidh mosmarreveshjet me te tretet.

- Nenshkruan per llogari te shoqerise kontratat,pervec atyre qe Asambleja i gjykon te kompetences se saj.
- Lidh kontratat individuale e kolektive te punes.
- Organizon veprimtarine e shoqerise.

Per te gjitha veprimet e kryera prej tij,administratori mban pergjegjesi para Asamblese se Ortakeve.

Neni 33

Administratoret jane pergjegjes individualisht per demet qe i kane sjelle shoqerise nga shkelja e statutit,dispozitave ligjore, ose fajeve te tjera te kryera gjate administrimit.

Aktet e administratorit e ngarkojne shoqerine teresisht,me perjashtim kur personat e trete e dinin se veprimi i administratorit kalonte kompetencat e veprimtarise se shoqerise.

Neni 34

Administratori pergatit raport per marreveshjet e arritura midis shoqerise nga njera ane dhe nje prej ortakeve te saj ose prej vete atij nga ana tjeter.

Neni 35

Shoqeria mund te caktoje eksperte kontabel per cdo vit financiar,te cilet emerohen nga Asambleja e Ortakeve.Asambleja emeron edhe zvences ekspert kontabel te autorizuar,ne rast mospranimi,pengimi,doreheqje ose vdekje te ekspertit kontabel.

Ekspertet kontabel mbajne pergjegjesi per shqyrtimin e llogarive dhe rregullshmerine e tyre.

Ekspertet kontabel mbajne pergjegjesi per demet qe i shkaktojne shoqerise nga pasaktesia e mbajtejes se llogarive dhe nga verifikimi i gabuar i tyre.

Themeluesit,administratoret,personat e afert gjini te tyre deri ne shkallen e katert te gjinise e krushqise,bashkeshortet e tyre,drejtuesit e filialeve e te zyrave nuk mund te ngarkohen me detyren e eksperteve apo zvences eksperteve kontabel.

Nuk mund te caktohen eksperte kontabel personat qe kane qene administratore ose te punesuar ne kete shoqeri deri pese vjet nga koha e largimit te tyre nga kjo shoqeri.

Neni 36

Nje ose disa ortake qe perfaqesojne 1/10 e kapitalit themelor brenda 30 diteve nga dita e caktimit,mund te kundershtojne ne gjykate ekspertet kontabel te autorizuar,te emeruar nga Asambleja dhe

te kerkojne nga Asambleja emerimin e eksperteve kontabel te autorizuar qe te ushtrojne funksionet ne vend te tyre.

Neni 37

Ne rast gabimi ose pengimi eksperti kontabel i autorizuar shkarkohet nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 38

Eksperti kontabel ka keto detyra:

- Garantojne qe llogarite vjetore jane te rregullta.
- Pershtatjen e kontabilitetit me legjislacionin ne fuqi.
- Perputhjen e informacioneve te dhena ne raportin e administrimit me llogarite vjetore.

Neni 39

Ekspertet kontabel mund te ndihmohen edhe nga eksperte ose bashkepunetore qe i zgjedhin vete ,duke ja u bere me pare te njohur shoqerise.

Neni 40

Ekspertet kontabel njoftojne Asamblene e Ortakeve per verifikimet qe kane kryer dhe sondazhet qe kane bere.

Neni 41

Ekspertet kontabel paguhen me honorare.

V. MARREDHENIET E PUNES

Neni 42

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me marreveshjen per themelimin e shoqerise,dispozitat e statutit te saj dhe legjislacionit shqiptar te punes.

Neni 43

Punesimi ne shoqeri behet sipas kontrates individuale te punes per cdo te punesuar ose grup te punesuarish.Marredheniet midis shoqerise dhe sindikates rregullohen nga kontrata kolektive e punes

Kontrata individuale e punes rregullon :

- Marrjen ne pune,kushtet e marrjes ne pune,vendin e punes,punen qe do te kryeje cdo i punesuar.
- Kohen e fillimit te marredhenieve te punes.
- Disiplinen e punes.
- Kohen ditore ose javore te punes,ditet e pushimit dhe kohen e pushimit javor e vjetor.

- Shperblimi per kohen e punes,per kohen jashte kohes normale te punes dhe punen naten.
- Caktimi i shperblimeve per plotesimin e detyrave.
- Pergjegjesia e sejciles pale per mosrespektimin e kontrates.
- Menyren e mbarimit te kontrates se punes.

## VI. MBYLLJA E SHOQERISE - LIKUIDIMI

Neni 44

Shoqeria do te vazhdoje veprimtarine per periudhen 10 vjecare nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar.

Veprimtaria e saj mund te nderpritet me propozimin e njerit ortak kur:

- Nuk rezulton rentabel gjate dy vjeteve te veprimtarise se saj.
- Kur parashikohet ne dispozitat e statutit ose kontraten e themelimit.
- Kur vendoset nga gjykata denimi i nje ortaku per kryerjen e veprave qe cenojne normat e statutit dhe te kontrates se themelimit, ose vertetohet se me faj ka demtuar rende interesat e ortakeve te tjere.

Neni 45

Kur vendoset shkrirja e shoqerise,Asambleja cakton likuidatorin ose keshillin e likuidimit,te cilet paraqesin bilancin e likuidimit.

Shoqeria gjate likuidimit mban shenimin "shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerise krijon pasoja ndaj te treteve mbas dates se publikimit te prishjes ne Regjistrin Tregetar.

Neni 46

Ortaket thirren ne fund te procesit te likuidimit per te vendosur bilancin financiar perfundimtar,aktin e rregullshmerise se likuidimit dhe heqjen e mandatit te likuidatorit.

Ne rast se ortaket nuk thirren,sejcili prej tyre mund te caktoje nje mandat mi ajtes per thirrjen e tyre nepermjet gjykates.

Neni 47

Kur Asambleja e ortakeve nuk vendos per aktet e mbylljes se likuidimit,likuidatori ose cdo person tjeter i interesuar kerkon mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes se likuidimit dhe aktet e treguara ne nenin 46 te statutit,se bashku me llogarite perfundimtare depozitohen ne regjistrin tregetar.

Neni 48

Mbas mbylljes se likuidimit dhe depozitimit te dokumenteve ne regjistrin tregetar,shoqeria cregjistrohet prej tij.

VII. DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 49

Likuidatori eshte pergjegjes per demet qe i shkakton shoqerise nga gabimet qe ka bere ne ushtrimin e detyres e funksionit te tij.Ai pergjigjet edhe per demet qe u shkakton te treteve gjate periudhes se likuidimit duke vepruar me kete cilesi.

Padia kunder likuidatorit parashkruhet me kalimin e afatit 3 vjecar nga data kur eshte kryer veprimi i demshem,ose nga data e zbulimit,kur ka qene i fshehur.

Ne rastet kur veprimi i demshem perben krim,padia parashkruhet me kalimin e 10 vjeteve.

Neni 50

Padia kunder ortakut qe nuk eshte likuidator ose bashkeshortit te tij qe eshte gjalle,trashegimtareve ligjore dhe testamentare qe kane perfituar nga trashegimia prej tij,parashkruhet me kalimin e pese vjeteve nga data e cregjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar.

Neni 51

Nepunesit e shoqerise si dhe te ngarkuarit me pune prej saj ose nga Asambleja e ortakeve dhe personat e tjere qe punojne per llogari te saj,mbajne pergjegjesi penale sipas neneve 296,297,300 e 301 te ligjit "Per shoqerite tregetare"kur konstatohet se me dashje shkelin detyrat e ngarkuara,qe i shkaktojne humbje shoqerise,ose me ndergjegje paraqesin te dhena te pavertete.

Neni 52

Statuti hyn ne fuqi mbas regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar ne Gjykaten e Rrethit Tirane.

Ky statut u lexua prej ortakeve,te cilet nuk kane verejtje, dhe u nenshkrua prej tyre me vullnet te lire.

ORTAKET THEMELUES

Kostandin Gjeta | Vnecti Foto | Sotir Lolo

Foto

# AKT THEMELIMI
# I SHOQERISE `TREG-TUR-KORÇA`
# SH.A KORCE

Me cilesine e aksionerit :
**Kostandin GJATA** i biri i Kristaqit , i datelindjes 28.02.1965 , lindur dhe banues ne Korce , aksioner i vetem i shoqerise "TREG TUR KORCA " Sh.A Korce me aksione 14.471, me vlere 144.712.506 lek , ose 100% te kapitalit themeltar

Bazuar ne vullnetin e Aksionerit te shprehur si dhe ne Dispozitat e ligjit Nr 7638, date 19.11.1992 `Per Shoqerite Tregetare` themelohet Shoqeria Tregetare `TREG-TUR-KORÇA`, SH.A Korce e cila do te funksionoje nbi dispozitat e Aktit te themelimit dhe te Statutit.
Shoqeria qe krijohet buron nga aktiviteti i saj ne formen si shoqeri me pergjegjsi te kufizuar, e themeluar nga ortaku Kostandin GJATA, e rregjistruar ne rregjistrin tregetar me Vendimin e Gjykates se Tiranes me Nr.15385, date 10.07.1996 . Me vendimet e Gjykates se Shkalles se Pare Nr.15385/7 Date 01.07.2004 ka realizuar zmadhimin e kapitalit te nenshkruar mbas themelimit te shoqerise deri ne shumen 144.712.506 leke, aksioneri themelues i saj, vendosi per shndrimin e saj nga cilesia Shpk ne cilesine Shoqeri Anonime.
Si themelues i shoqerise tregetare `TREG-TUR-KORÇA` ka vendosur sa me poshte:

**Neni 1**

Te themeloje Shoqerine Tregetare `TREG-TUR-KORÇA` Sha, Korce ne formen e nje Shoqerie anonime pa oferte publike. Ne te gjitha aktet qe do te nxjere shoqeria kundrejt te treteve si edhe ne te gjitha aktet e brendshme te saj, do te shenohet detyrimisht emri `TREG-TUR-KORÇA` Sha Korce.

**Neni 2**
**Qellimi dhe objekti i Shoqerise**

Qellimi i kesaj Shoqerie eshte te operoje ne fushen e :
Tregtise se mallnave te te gjitha llojeve te prodhimeve industriale, ushqimore etj ne fushen e ndertimit te projektimit e zbatimit , ne fushen e turizmit dhe te transportit kombetar dhe nderkombetar, ne fushen e gazit te lengshem , ne fushen e transportit te te gjitha mallnave.

**Neni 4**
**Emri i Shoqerise**

Shoqeria do te ruaje emrin `TREG-TUR-KORÇA` Sha. Ky emer do te mbetet i tille edhe ne raste te transferimit te titullit te aksioneve te kesaj shoqerie ne persona te trete.
Shoqeria ka te drejte te perdore emrin e saj per qellime ekonomike sipas vendimeve te organeve drejtuese te saj.

**Neni 5**

Objekti i veprimtarise se kesaj Shoqerie do te jete:

- Import eksport te prodhimeve bujqesore, blektorale, industriale, fruta perime, dhe transportimin e te gjithe ketyre mallrave.
- Import eksport te materialeve ndertimore, lende drusore, materiale inerte, tulla, etj dhe transportimin e tyre.
- Ndertim te objekteve shumekateshe, ndertesave, projektim dhe studim.
- Transport te udhetareve, linjat kombetare e nderkombetare.
- Hoteleri dhe turizem.
- Import e eksport te produkteve e nenprodukteve te gazit te lengshem etj.

**Neni 6**

Selia e shoqerise eshte ne Korce, ku do te ndodhet edhe drejtoria e saj ne adresen:
Rruga Korce – Maliq kilometri 1 Korce

**Neni 7**

Kapitali i nenshkruar i shoqerise perbehet nga kontributi ne te holla dhe nga kontributi ne natyre i aksionereve themelues te kesaj Shoqerie.
Kontributi i plote do te jete i perbere nga shuma 144.712.506 leke , shume e shlyer teresisht ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate themelimi nga aksioneri i kesaj Shoqerie.
Ne kapitalin e nenshkruar te Shoqerise si dhe ne raportin midis aksionereve eshte mbajtur parasysh dhe jane perfshire edhe investimet qe kane bere aksioneret e kesaj shoqerie si investime ne te holla ashtu edhe ne natyre. Percaktimi i vleres se tyre do te behet sipas rregullave qe percakton per kete qellim ligji `Per Shoqerite Tregtare` dhe ne momentin e themelimit te shoqerise.

**Neni 8**

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 14.471 aksione me vlere nominale prej 10.000 leke per nje aksion.
Aksioneri i Shoqerise Tregtare `TREG-TUR-KORÇA` Sha zoteron 100% te vleres se aksioneve ne kapitalin e Shoqerise si me poshte:

1. Zoti Kostandin GJATA

**Neni 9**

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. **Asambleja e Aksionereve ,** e cila perfaqsohet nga aksioneri themelues i shoqerise , i cili perfaqeson ne kete asamble vleren e pergjithshme te aksioneve ne kapitalin e Shoqerise.
2. **Drejtoria e Shoqerise** perbehet nga nje anetar i vetem dhe si shoqeri me vlere kapitali themeltar mbi 10 milion lek , anetari i drejtorise te quhet Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise. Drejtori emerohet per nje periudhe kohe prej 3 vjet, me te drejta riemerimi. Emerimi i tij behet nga Keshilli mbikqyres.

## Neni 10

**Keshilli mbikqyres i Shoqerise** perbehet nga tre anetare , te cilet 2 anetare rrjedhin nga perfaqsues i te punesuarve. Caktohen Anetare te Keshillit mbikqyres si me poshte:

| | | |
|---|---|---|
| 1.Kostandin | GJATA | Kryetar i Keshillit Mbikqyres |
| 2.Kristaq | GJATA | Zv/kryetar |
| 3.Meleq | NANO | Anetar |

Kohezgjatja e anetareve te Keshillit Mbikqyres do te jete jo me shume se tre vjet.

## Neni 11

**Ekspertet Kontabel te Autorizuar te Shoqerise** do te emerohen ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe per cdo vit financiar te ushtrimit te veprimtarise se shoqerise. Shoqeria do te kete nje ekspert kontabel. Eksperti i pare kontabel do te jete Z.Dhimitraq PANO.

## Neni 12

Organizimi dhe funksionimi i shoqerise, ngritja e degeve apo filialeve te saj do te behet ne perputhje me dispozitat e Statutit se Shoqerise.

**AKSIONERI I SHOQERISE**

**Kostandin GJATA**

TREG. TURIZ KORÇA
IMP. EKS. FRUTA PERIME
TEL. FAKS. 00355 824 3815
KORÇA ALBANIA

## STATUTI
## I SHOQERISE 'TREG-TUR-KORÇA' SH.A. KORÇE

Sot me date 29.06.2005 ne Korce , nenshkruhet ky statut nga personi i meposhtem:
**Z. Kostandin GJATA**

## KREU I
## FORMA LIGJORE, EMERTIMI , SELIA E SHOQERISE

### Neni 1
### Forma juridike

Bazuar ne vullnetin e Aksionerit te shprehur ne Aktin e themelimit si dhe ne Dispozitat e ligjit Nr.7638 Date 19.11.1992 'Per Shoqerite Tregtare' themelohet Shoqeria Tregtare ''TREG-TUR-KORÇA' Sha. Korce, e cila do te funksionoje mbi dispozitat e aktit te themelimit dhe ketij statuti.
Shoqeria qe krijohet buron nga aktiviteti i saj ne Formen si Shoqeri me pergjegjsi te kufizuar, e themeluar nga ortaku Kostandin GJATA , e rregjistruar ne rregjistrin tregetar me Vendimin e Gjykates se Tiranes me Nr. 15385 , date 10.07.1996 . Me vendimet e Gjykates se Shkalles se Pare Nr.15385/7 Date 01.07.2004 ka realizuar zmadhimin e kapitalit te neneshkruar mbas themelimit te shoqerise deri ne shumen 144.712.506 leke, dhe nga aksioneri themelues i saj, vendosi per shndrimin e saj nga cilesia Shpk ne cilesine Shoqeri Anonime.

### Neni 2
### Emertimi i Shoqerise

Emertimi i Shoqerise eshte 'TREG-TUR-KORÇA' Sh.a. Korce. Per efekt te ketij statuti Shoqeria me poshte do te quhet Shoqeria 'TREG-TUR-KORÇA' Sh.a. Korce. Shoqeria do te ruaje emrin e saj. Shoqeria ka te drejte te perdore emrin e saj per qellime ekonomike sipas vendimeve te organeve drejtuese te saj.

### Neni 3
### Objekti i veprimtarise

Objekti i Veprimtarise se kesaj Shoqerie do te jete:

- Import eksport te prodhimeve bujqesore, blektorale, industriale, fruta perime, dhe transportimin e te gjithe ketyre mallrave.
- Import eksport te materialeve ndertimore, lende drusore, materiale inerte, tulla, etj dhe transportimin e tyre.

- Ndertim te objekteve shumekateshe, ndertesave, projektim dhe studim.
- Transport te udhetareve, linjat kombetare e nderkombetare.
- Hoteleri dhe turizem.
- Import e eksport te produkteve e nenprodukteve te gazit te lengshem etj.

**Neni 4**
**Selia, Deget , Agjensite dhe Zyrat e Perfaqsimit.**

Selia e shoqerise eshte ne Korce ku do te ndodhet edhe Drejtoria e saj ne rrugen:

Veprimtaria e shoqerise do te shtrihet ne gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise. Shoqeria mund te cele dege, agjensi dhe zyra perfaqsimi te reja si brenda teritorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe jashte saj. Ato celen dhe mbyllen me vendim te Keshillit Mbikqyres.

## KAPITULLI II
## KAPITALI I SHOQERISE, AKSIONET, NDRYSHIMET E KAPITALIT

**Neni 5**
**Kapitali themeltar i Shoqerise**

Kapitali i nenshkruar i Shoqerise eshte: 144.712.506 lek Ai eshte i ndare ne 14.471 aksione te se njejtes kategori me vkere nominale prej 10.000 lek per cdo aksion te shlyer per teresine e vleres nominale te tyre. Aksionet jane te numertuara nga nje deri ne katermbedhjetemije e katerqindeshtatdhjetenje aksione. Perqindja e pjesemarjes e Themeluesit te Shoqerise ne aksione eshte:

1. **Kostandin GJATA 100%**

**Neni 6**
**Forma e aksioneve**

Aksionet e Shoqerise jane nominative. Pronesia e aksioneve vertetohet nga rregjistrimi i tyre ne emer te pronareve ne rregjistrin e mbajtur per kete qellim nga shoqeria sipas menyres se parashikuar ne ligj. Me kerkesen e aksionereve shoqeria i leshon atyre nje vertetim te rregjistrimit te aksioneve ne pronesi te tyre.

**Neni 7**
**Shitja dhe Transferimi i Aksioneve**

Pervec rastit te trashegimise , transferimi i pronesise mbi aksionet te nje i trete pavarsisht nga baza juridike e ketij transferimi , duhet te miratohet nga Keshilli Mbikqyres ne kushte dhe sipas procedurave te parashikuara ne Nenin 207 te ligjit 'Per Shoqerite Tregetare'.
Ne rast se Keshilli Mbikqyres refuzon shitjen e aksioneve nje bleresi joaksioner shitesi duhet te njoftoje shoqerine me nje leter rekomande brenda 8 diteve nga data e njoftimit te realizuar ne se ka hequr dore nga projekti i shitjes se aksioneve.
Ne rast se shitesi nuk heq dore nga ky projekt Keshilli Mbikqyres duhet te siguroje blerjen e aksioneve prej nje ose disa personave te zgjedhur prej tij.
Ne qofte se per vleresimin e aksioneve nevojitet vleresim prej Ekspertit Kontabel , shpenzimet per kete qellim paguhen pergjysem midis shitesit dhe bleresit.

**Neni 8**
**Zmadhimi i kapitalit Themeltar**

Shoqeria mund ta zmadhoje kapitalin e saj. Menyrat dhe rregullat e ketij ndryshimi jane ato te parashikuara ne Nenet 150-163 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 'Per Shoqerite Tregetare'.
Zmadhimi i kapitalit mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme se Aksionereve ne baze te raportit te drejtorise se kerkuar nga ligji.
Aksioneret kane te drejten e perparesise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejte eshte ne perpjestim me shumen e aksioneve te zoteruara nga aksioneri para zmadhimit te kapitalit.
Aksioneret mund te heqin dore vetem individualisht nga e drejta per nenshkrimin e nje numri me te vogel aksionesh nga sa i takon sipas parimit te perpjesteueshmerise , por me kusht qe asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete gje.

**Neni 9**
**Shlyerja e aksioneve**

Aksionet per kapitalin ne para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit do te shlyhen 100% te vleres se tyre qe ne castin e nenshkrimit.
Pjesa tjeter e vleres do te shlyhet me keste ne baze te kerkimit per shlyerje te Keshillit Mbikqyres , brenda nje afati 3 vjet nga data kur zmadhimi i kapitalit eshte kryer perfundimisht.
Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme qe vendos zmadhimin e kapitalit ka te drejte te mare vendime per shlyerjen teresore te aksioneve qysh ne castin e nenshkrimit ose brenda nje afati me te shkurter nga ai i percaktuar ne paragrafin e dyte te ketij neni.
Kerkimi i fondeve u njoftohet nenshkruesve te pakten 15 dite perpara dates se caktimit per cdo derdhje me leter rekomande dhe kthim pergjigje cdo aksioneri.
Cdo vonese ne derdhjen e shumave te kerkuara sjell pagimin e interesave sipas perqindjeve te caktuara ne ligj, duke filluar nga data e kerkimit te cdo derdhje , pa qene nevoja per te proceduar me formalitete te tjera te cfaredoshme dhe pa hequr dore nga veprimet e shoqerise ndaj aksionerit detyrues si dhe nga masa e zbatimit te detyruar, te parashikuar me ligj.

**Neni 10**
**Zvogelimi i Kapitalit**

Zvogelimi i Kapitalit te shoqerise kryhet vetem me Vendim te Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme te aksionereve dhe ne pajtim me dispozitat e Neneve 164-166 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 `Per Shoqerite Tregetare`. Zvogelimi i Kapitalit nuk duhet te cenoje raportet e aksionereve perpara ketij zvogelimi.
Kapitali Themeltar nuk mund te zvogelohet nen shume minimale te kerkuar nga ligji.

**Neni 11**
**Te Drejtat dhe Detyrimet e lidhura me aksionet**

Cdo aksion i derdhur ne te holla, jep te drejten e pjsemarjes ne fitimet vjetore te shoqerise te destinuara per shperndarje dhe ne tepricen e aktivitetit te mbetur ne rastin e likujdimit ne perpjestim me aksionet qe zoteron. Vetem pronesia mbi aksionet e derdhura ne te holla jep te drejten e votes dhe ate te perfaqsimit ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme sipas kushteve te percaktuara ne Ligj dhe ne Statut.
Aksioneret pergjigjen per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve ashtu dhe per humbjet e saj deri ne masen e shumes nominale te aksioneve qe zoteron. Ndalohet kerkimi i fondeve te kesaj shume.
Kur aksionet u kalojne aksionereve te rinj , keta ruajne te drejtat dhe detyrimet qe vijne nga aksionet.
Pronesia e nje aksioni permban automatikisht te drejten e aderimit ne Statutin e shoqerise dhe ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme.

## KAPITULLI III
## DREJTIMI I SHOQERISE
## SEKSIONI I

**Drejtoria**

**Neni 12**
**Perberja dhe Emerimi**

Drejtimi i pergjithshem i shoqerise kryhet nga Drejtoria e cila per Shoqerine 'TREG-TUR-KORÇA` Sh.a, Korce do te perbehet nga nje anetar detyrimisht person fizik .
Drejtori i Pergjithshem emerohet dhe shkarkohet nga Keshilli Mbikqyres. Drejtori i Shoqerise Tregetare 'TREG-TUR-KORÇA` Sh.a, Korce ushtron funksionin e tij nen kontrollin e Keshillit Mbikqyres.

**Neni 13**
**Kohezgjatja e Funksioneve te Drejtorit**

Drejtori emerohet per nje periudhe kohe prej 3 vjetesh, me te drejta riemerimi. Ai duhet te jete nga radhet e aksionereve si dhe mund te shkarkohet nga detyra e tij me vndim te Keshillit Mbikqyres per shkaqe te perligjura.

Ne qofte se vendi i Drejtorit mbetet bosh, zevendesimi i tij behet nga Keshilli Mbikqyres. Anetari zevendesues mbetet i tille deri ne emrimin pasardhes te Drejtorit tjeter te Drejtorise.

**Neni 14**

**Shkarkimi i Drejtorit**

Drejtori mund te shkarkohet gjate mandatit te tij ne rsatet kur:

1. Eshte shpallur fajtor me vendim te formes se prere te gjykates per kryerjen e nje vepre penale qe ka lidhje me veprimtarine ekonomike-financiare.
2. Eshte vertetuar se ka shpqerdoruar fondet e shoqerise.
3. Jane rastet e parashikuara ne Nenin 98 te ligjit 7638 date 19.11.2002 'Per Shoqerite Tregetare'.

**Neni 15**

**Perfaqesimi i Shoqerise**

Shoqeria perfaqesohet nga Drejtori i saj ose personi i autorizuar rregullisht prej tij para te gjithe institucioneve publike dhe private , organeve gjyqesore si edhe ne marredheniet me te trete.

**Neni 16**

**Mbledhja e drejtorise dhe Vendimet**

Mbledhja e drejtorise drejtohet nga Drejtori i saj ose personi i autorizuar rregullisht prej tij. Mbledhja e drejtorise zhvillohet si rregull ne seline e shoqerise. Ato drejtohen nga Drejtori ligjor i saj, i cili kryen dhe procedurat e nevojshme per thirjen e mbledhjes.

**Neni 17**

**Kopetencat e Drejtorit**

Drejtori ka kopetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise ne cdo rrethane. Ai i ushtron keto kopetenca brenda kufijve te objektit te shoqerise dhe kufizohet vetem ne ato kopetenca qe ligji dhe ky statut ua jep shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese se Aksionereve.

**Neni 18**

**Operacionet e autorizuara**

Drejtori kerkon autorizimin paraprak nga Keshillit Mbikqyres per:

a. Krijimin e garancive me ane te pasurise se shoqerise.
b. Kryerjen e investimeve qe nuk perfshihen ne programin financiaro-vjetor.
c. Celjen e veprimtarive ose degeve dhe agjensive te reja.
d. Shkrirjen , bashkimin dhe mbylljen teresisht ose pjeserisht e veprimtarive dhe e degeve te shoqerise.
e. Pjesemarjen ne shoqeri te tjera.
f. Shitjen dhe shkembimin e pasurive qe perbejne aktive te qendrueshme te shoqerise.
g. Lidhjet ose ndryshimet e kontratave qe kaperxejne vleren e caktuar nga Keshilli Mbikqyres.

Kur Keshilli Mbikqyres refuzon te jape autorizimin e kerkuar Drejtori mund tí kerkoje aksionereve te urdherojne Keshillin Mbikqyres te leshoje autorizimin ose ta autorizoje vete ate.

**Neni 19**
**Shperblimi i Anetarit te Drejtorise**

Masa e shperblimit te Drejtorit caktohet nga Mbledhja e Asamblese se Aksionereve.

**Neni 20**
**Pergjegjesia e Anetareve te Drejtorise**

Drejtori eshte pergjegjes civilisht dhe penalisht per aktet e drejtimit te shoqerise ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi.

## SEKSIONI 2
## KESHILLI MBIKQYRES

**Neni 21**
**Perberja dhe Emerimi i Keshillit Mbikqyres**

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 anetare. Anetaret e Keshillit Mbikqyres rrjedhin dhe emerohen nga Anetaret e Asamblese se Aksionereve si dhe perfaqsues nga te punesuarit ne shoqeri. Perfaqsuesi anetar i keshillit mbikqyres qe perfaqson edhe interesat e punemarresve.

**Neni 22**
**Personi Juridik , Anetar i Keshillit Mbikqyres**

Nje person juridik (ne kuptimin e shoqerive tregetare e tregetar jo fizik) qe eshte aksioner i shoqerise nuk mund te jete anetar i Keshillit Mbikqyres. Ne kete rast ky duhet te caktoje qe ne castin e zgjedhjes nje perfaqsues te perhershem person fizik, i cili u nenshtrohet te njejtave kushte dhe detyrime dhe ka te njejtat cilesi civile e penale si te ishte ai vete anetar i Keshillit , duke mos perjashtuar nga pergjegjsia e perbashket dhe personin juridik qe ai perfaqson.

Ne qoftese personi juridik i revokon mandatin perfaqsuesit te tij ai duhet te njoftoje per kete shoqerine pa vonese dhe te beje zevendesimin e tij. Ky rregull do te zbatohet dhe ne rastin e vdekjes , te doreheqjes ose te pengimeve te zgjatura te perfaqsuesit te perhershem.

**Neni 23**
**Kohezgjatja e Funksioneve dhe Vendet bosh**

Kohezgjatja e Funksioneve te anetareve te Keshillit Mbikqyres eshte tre vjet. Nje vit do te llogaritet periudha midis dy mbledhjeve vjetore te Asamblese se Pergjithshme.

Ne qofte se nje ose disa vende te anetareve te Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga Asambleja mbeten bosh per shkak te vdekjes, doreheqjes ose pengimit per nje kohe te gjate Keshilli njofton Asamblene e aksionereve te cilet bejne zevendesimet perkatese.

## Neni 24
## Kryetaret dhe Zv/Kryetari i Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres nga perberja e tij ka nje Kryetar dhe nje Zv/Kryetar , qe ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve te Keshillit. Ata ushtrojne funksionet e tyre gjate tere periudhes se mandatit te dhene. Kryetari dhe nje Zv/Kryetari I Keshillit Mbikqyres mund te rizgjidhen. Keshilli Mbikqyres mund te emeroje nje sekretar te zgjedhur midis anetareve te Keshillit ose jashte tyre duke percaktuar dhe kohezgjatjen e funksionit te tij.

## Neni 25
## Mbledhja e Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres mblidhet me thirjen nga Kryetari. Ne mungese te tij aim und te mblidhet dhe nga Zv/Kryetari sa here e kerkon interesi I shoqerise dhe sa here shtrohen ceshtje per t'u zgjidhur dhe qe jane ne kopetence te Keshillit. Ne cdo rast Keshilli detyrimisht duhet te mblidhet nje here ne 3 muaj, mbledhjet e tij zhvillohen sipas rregullores se vecante te ketij Keshilli Mbikqyres.
Thirja e mbledhjes se Keshillit behet me cdo lloj menyre. Kryetari I Keshillit Mbikqyres duhet te therase mbledhjen e Keshillit Brenda 15 diteve kur kete e kerkon Drejtori I Pergjithshem ose nje e treta e anetareve te tij nepermjet nje kerkese te motivuar. Ne qofte se kerkesa nuk merr pergjigje kerkuesit mund te procedojne vete me thirjen e mbledhjes se Keshillit Mbikqyres duke beret e ditut rendin e dites se mbledhjes.
Mbledhja e Keshillit Mbikqyres mbahet ne seline e shoqerise. Rendi I dites vendoset nga Kryetari e ne mungese te tij nga Zv/Kryetari ose nga Drejtori apo nga anetaret e Keshillit Mbikqyres kur mbledhja eshte kerkuar prej tyre.
Cdo anetar I Keshillit Mbikqyres mund ti jape mandate nje anetari tjeter per te perfaqsuar ne nje séance te Keshillit. Cdo anetar mund te jape vetem nje mandate per te njejten séance.
Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres jane te vlefshme kur numri I anetareve te pranishem ne mbledhje eshte te pakten sa gjysma e anetareve ne funksion. Vendimet meren me shumicen e votive te anetareve te pranishem dhe atyre te perfaqsuar.
Ne rast votash te barabarta ajo e Kryetarit eshte percaktuese. Ne seline e shoqerise mbahet nje rregjister I pranise se anetareve ne mbledhje , i cili firmoset nga anetaret pjesemarres ne seance.
Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres evidentohen me procesverbale te hartuara ne nje rregjister te posacem, te numertuar dhe te vulosur dhe qe mbahet ne seline e shoqeise. Ne kete procesverbal tregohen anetaret e pranishem, te perfaqesuarit dhe ata qe mugojne si dhe cdo person qe ka asistuar ne mbledhje teresisht apo pjeserisht. Procesverbali firmoset nga te gjithe anetaret e pranishem.

## Neni 26
## Kopetencat e Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres ushtron mbikqyrje ne menyre te perhershme ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise nga ana e Drejtorise. Ai vendos per operacionet qe duhet te kryhen me autorizimin e tij ne baze te Nenit 19 te ketij Statuti.

Keshilli Mbikqyres miraton programe vjetore te zhvillimit te shoqerise si dhe planin ekonomiko-financiar dhe ja paraqet per miratim perfundimisht Asamblese se Aksionereve.
Keshilli Mbikqyres miraton strukturen organizative te shoqerise te shoqerise dhe ndryshimet e saj, kriteret e punesimit dhe te pagave si dhe rregulloren e brendshme te shoqerise.
Ne cdo kohe te vitit Keshilli Mbikqyres kryen te gjitha verifikimet dhe kontrollet qe ai shikon te arsyeshme dhe ka te drejte te njihet me dokumentat qe ai gjykon te nevojshme per permbushjen e funksioneve te tij.
Keshilli Mbikqyres vepron si nje i tere. Ne rast marrje te nje vendimi edhe personat qe kane votuar kunder jane te detyruar te pranojne vendimin dhe te kontribuojne ne zbatimin e tij.
Meyra e zakonshme e votimit ne Keshillin Mbikqyres eshte ajo e theshta, me shumice votash (50 + 1), pervec rasteve te parashikuara ndryshe ne kete statut.
Kryetari i Keshillit Mbikqyres apo Anetari qe mbulon shpenzimet dhe te ardhurat e realizuara nga aktiviteti sipas informacioneve qe ka mare nga Drejtoria , raporton nje here ne muaj para Keshillit Mbikqyres per shpenzimet per muajin perkates.
Vendimet e Keshillit Mbikqyres jane te detyruara per zbatim nga cdo strukture tjeter.
Brenda tre muajve nga mbyllja e cdo viti financiar Drejtori i Pergjithshem i paraqet Keshillit Mbikqyres me qellim verifikimi e kontrolli llogarite vjetore si edhe nje raport te shkruar per gjendjen e shoqerise dhe aktivitetin e saj gjate vitit financiar te mbyllur.

**Neni 27**

**E drejta per infrmim e cdo anetari te Keshillit**

Cdo anetar i Keshillit Mbikqyres ka te drejte te kerkoje dhe te mare nga Drejtori informacion per ceshtje te natyres administrative, teknike dhe financiare qe i mundesoje atij te verifikoje dhe gjykoje per kushtet ne te cilat zhvillohet veprimtaria e shoqerise dhe te jete plotesisht i qarte per vendimet qe duhet te mare ose te meren nga Keshilli.
Kryetari i Keshillit ka pergjegjsine per t`i vene anetaret e Keshillit qe te marin informacionet e kerkuara. Cdo anetar i Keshillit duhet te njoftohet pesonalisht per mbledhjet e Keshillit duke ju vene ne dispozicion ne seline e shoqerise dokumenta dhe raporte qe do te shqyrtohen ne mbledhje.
Shoqeria nuk eshte e detyruar t`ju jape anetareve te Keshillit kopje te proces-verbaleve te vendimeve te Keshillit. Ata mund te njihen me to ne seline e shoqerise. Mosnjohja e te dejtave te cdo anetari te Keshillit per informacionet e mesiperme dhe mosthirrja ne mbledhje te Keshillit sjell pavlefshmeri te vendimeve te Keshillit.

**Neni 28**

**Shperblimi per anetaresimin ne Keshill dhe shperblimet e jashtezakonshme.**

Asambleja e Pergjithshme e zakonshme e aksionereve mund t`ju caktoje anetareve te Keshillit Mbikqyres si shperblim per pjesemarrjen ne Keshill nje shume fikse per cdo mbledhje e cila mbetet e pandryshuar deri ne nje vendim te kundert te Asamblese se Aksionereve.
Keshilli Mbikqyres mund te caktoje shperblime te jashtezakonshme per anetaret te cileve u ngarkon sherbime apo detyra te posacme. Shperblimet e jashtezakonshme i nenshtrohen detyrimisht miratimit nga Asambleja e Pergjithshme sipas rregullave te parashikuara ne Nenet 122-125 te ligjit `Per Shoqerite Tregetare`. Shperblimet e vecanta dhe te jashtezakonshme perballohen nga llogaria e shoqerise dhe kalohen ne shpenzimet e saj.

Perveç shperblimeve te permendura ne kete nen, anetareve te Keshillit Mbikqyres nuk u caktohet asnje lloj tjeter shperblimi i perhershem ose jo.

## SEKSIONI 3
## DISPOZITA TE PERBASHKETA PER DREJTORIN DHE ANETARET E KESHILLIT MBIKQYRES

### Neni 29
### Marreveshjet qe kerkojne autorizim

Cdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe Drejtorit ose te Keshillit Mbikqyres, qe lidhen drejtperdrejt apo me te cilen nje nga personat e siperpermendur lidhet indirekt apo nepermjet nje personi ndermjetes, do te autorizohet paraprakisht nga Keshilli Mbikqyres.
Kryetari i Keshillit Mbikqyres njofton Ekspertin Kontabel te Autorizuar me marreveshje te autorizuara nje muaj perpara se marreveshja te lidhet dhe ja shtron keto marreveshje per miratim Asamblese se Pergjithshme te ortakeve.
Ekspertet Kontabel te Autorizuar i paraqesin Asamblese se ortakeve nje raport te posacem per keto marreveshje e cila vendos mbi kete raport.
Dispozitat e mesiperme nuk zbatohen per marreveshjet qe kane te bejne me operacione rrjedhese dhe te kryera ne kushte normale.

### Neni 30
### Marreveshjet e ndaluara

Anetareve te Drejtorise dhe te Keshillit Mbikqyres u ndalohet te kontraktojne qe te marri hua nga shoqeria, t`ju akordohet nga shoqeria nje zbulim ne llogarine rrjedhese ose ne nje forme tjeter ose te bejne shoqeri dorezenese apo garantuese per detyrimet e tyre personale ndaj te treteve.
Kjo dispozite nuk zbatohet ne rastin kur keta persona kontraktojne me shoqerine per marrjen e tyre ne sigurim apo per marrjen e veprimtarive dhe mallrave qe lidhen me kete veprimtari direkt me karakterin e tyre diagnostifikues apo kurues.
Ky ndalim zbatohet per perfaqesuesit e perhershem te personave juridike, anetare te Keshillit Mbikqyres si edhe per bashkeshortet , paraardhesit dhe pasdardhesit e personave te permendur ne kete Nen si edhe per cdo ndermjetes.

### Neni 31
### Detyrimet per ruajtjen e sekretit

Drejtori dhe anetaret e Keshillit Mbikqyres si dhe cdo peson tjeter qe asiston ne mbledhjen e ketyre organeve duhet te ruaje fshehtesine per ceshtjet dhe te dhenat qe kane karakter te brendshem.

## KAPITULLI IV
## ASAMBLEJA E PERGJITHESHME E AKSIONEREVE

### Neni 32
### Mbledhjet e Asamblese dhe efektet detyruese te vendimeve

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve jane te zakonshme dhe te jashtezakonshme, ne varesi te natyres se ceshtjeve qe diskutohen dhe vedimeve qe do te merren. Cdo Asamble e Pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqson tereine e aksioeve te zoteruara nga aksioneret sipas Nenit 5 te ketij Statuti.

### Neni 33
### Organizimi i Mbledhjeve te Asamblese

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve thirret nga Presidenti i Asamblese, nga Keshillit Mbikqyres Keshilli Mbikqyres ose nga Drejtori i Pergjithshem. Edrejta per thirrjen e mbledhjes nga Drejtori behet mbi bazen e rregullave te funksionimit si organ kolegjial. Mbledhja e Asamblese mund te thiret gjithashtu nga Eksperti Kontabel i Autorizuar ne raste urgjente ose nga nje mandatmbajtes i caktuar nga Gjykata dhe kur eshte rasti nga likujduesi.

Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter te treguar ne thirrje. Thirrja e Asamblese se ortakeve behet me ane te njoftimit qe u dergohet atyre ne adresat perkatese me leter rekomande.

Njoftimi duhet te mberije tek aksioneri apo te njihet prej tij 15 dite para mbledhjes se Asamblese. Ai duhet te permbaje daten, oren dhe vendin e mbledhjes si dhe natyren e Asamblese dhe rendin e dites. Kur Asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar quorumi i caktuar, mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare ne te njejten menyre si e para.

### Neni 34
### Rendi i dites

Rendi i dites i mbledhjes se Asamblese percaktohet nga autori i thirjes. Shumica e aksionereve mund ta ndryshoje ate duke e shtuar ose pakesuar. Keto projekt-rezoluta dergohen ne seline e shoqerise te shoqeruara me nje kerkese ne te cilen tregohen dhe arsyet si dhe nje dokument qe provon zoterimin e pjeses se kapitalit themeltar te cdo aksioneri. Projekt-rezoluta dhe dokumentat shoqeruese duhet te mberijne ne seline e shoqerise te pakten pse dite para mbledhjes se Asamblese.

Asambleja e aksionereve nuk mund te marre ne shqyrtim nje ceshtje qe nuk eshte perfshire ne rendin e dites; megjithate ajo mundet ne cdo rrethane te shkarkoje nje ose disa anetare te Keshillit Mbikqyres dhe te beje zevendesimin e tyre.

**Neni 35**
**Evidenca e pjesemarrjes , Drejtimi i mbledhjes dhe Proces-verbalet**

Per cdo mbledhje te Asamblese mbahet nje flete pranie e cila permban treguesin qe provon identitetin e cdo aksioneri dhe aksionet e zoteruara prej tij. Flete-prania firmoset ne ane nga aksioneret ose kur eshte rasti nga perfaqesuesit e tyre dhe vertetohet per saktesine e saj nga Komisioni vezhgues i mbledhjes.
Per cdo mbledhje te Asamblese hartohet nje proces-verbal i cili permban:

- daten dhe vendin e mbledhjes
- menyren e thirrjes
- rendin e dites
- drejtuesi i mbledhjes dhe komisioni i vezhgimit
- numri i aksionereve qe marin pjese ne votim
- quorumi i arritur
- permbledhjen e dokumentave dhe raporteve qe jane shtruar ne mbledhje
- nje permbledhje te debateve
- tekstet e projekt-rezolutave te vena ne votim, ato te miratuara dhe ato te refuzuara (hedhur poshte) nga aksioneret
- rezultatet e votomit ne cdo rast

Proces-verbalet e mbledhjes se Asamblese hartohen ne nje rregjister te posacem, te miratuar dhe te vulosur i cili ruhet ne seline eshoqerise.

**Neni 36**
**Quorumi, Votimi, Numerimi i votave**

Ne mbledhjen e pergjithshme te zakonshme dhe te jashtezakonshme quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar ne te holla te shoqerise. E drejta e votes qe u perket aksionereve eshte perpjestimore me kapitalin qe ata perfaqsojne.

**Neni 37**
**Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme**

Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit brenda tre muajve te vitit pasardhes per te vendosur mbi llogarite e shoqerise per vitin financiar te mbyllur.
Ajo ka nder te tjera kopetencat qe vijojne:

- te miratoje strategjine e zhvillimit afatgjate te shoqerise
- te miratoje plan-biznesin dhe planet finaciare vjetore
- te miratoje, ndryshoje ose te refuzoje llogarite vjetore qe jane shtuar per miratim sipas bilanceve te hartuara per kete qellim
- te vendose per shperndarjen dhe destinimin e rezultatit financiar ne perpjestim me dispozitat ligjore dhe statutin

- te zgjedhe Presidentin e Asamblese, te emeroje dhe shkarkoje anetaret e Keshillit Mbikqyres
- te emeroje Ekspertin ose Ekspertet Kontabel te Autorizuar
- te miratoje shkarkimet me vendim te Keshillit Mbikqyres per anetaret e Drejtorise
- te miratoje ose te refuzoje emerimet e anetarve te Keshillit Mbikqyres te kryera nga Keshilli si emerime te perkohshme
- te miratoje pagen e Drejtorit te saj dhe raportet e pagave per kategorite e tjera te personelit te shoqerise si dhe shperblimet suplementare qe mund t`ju jepen per pune ose rezultate te mira
- te caktoje shperblimin e zakonshem si dhe shperblime te tjera te paparashikuara ne kete statut per Keshillin Mbikqyres
- te vendose per raportet e Ekspertit Kontabel te autorizuar lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te Keshillit Mbikqyres

Asambleja e Zakonshme e Ortakeve mund te marre cdo vendim tjeter qe i shtrohet per zgjidhje por qe nuk sjell ndyshime te statutit.
Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqsua zoterojne jo me pak se 2/3 e aksioneve me te drejte vote. Ne rast se mbledhja e pare nuk realizohet , ne mbledhjen e dyt nuk kerkohet asnje lloj kufizimi. Asambleja e Zakonshme merr vendime me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te paerfaqsuar.

**Neni 38**
**Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme e Aksionereve**

Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme e Aksionereve mblidhet sa here eshte e nevojshme marrja e nje vendimi qe sjell ndryshim te ketij statuti. Ajo nuk mund te shtoje detyrimet e aksionerit pervec operacioneve qe rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.
Ajo merr vendime te vlefshme kur aksioneret e pranishem zoterojne jo me pak se 67% te aksioneve ose 2/3 e tyre.

**Neni 39**
**Venia ne dispozicion te Aksionereve te dokumentave dhe informacioneve**

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve ne kushte dhe afate te parashikuara nga ligji raportet , dokumentat dhe llogaritjet vjetore qe shqyrton Asambleja. Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje dokumenti tjeter te caktuar nga vete Asambleja dokumentat qe duhet t`ju vihen ne dispozicion aksionereve ju dergohen atyre bashke me njoftim-thirrje per mbledhje.

## KAPITULLI 5
## KONTROLLORE TE PAVARUR
## (Eksperti Kontabel i Autorizuar)

**Neni 40**
**Emerimi dhe shperblimi**

Asambleja e Aksionereve cakton nje kontrollor te pavarur te zgjedhur nga lista e Institutit te Eksperteve Kotabel te Autorizuar. Asambleja mund te caktoje po nga lista e Eksperteve Kontabel dhe nje ndihmes ekspert te autorizuar.

Ne caktimin e Kontrolloreve te pavarur mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtueshmerite e caktuara nga ligji 7638 date 19.11.1992 'Per Shoqerite Tregetare'.
Kontrolloret e pavarur caktohen per nje kohe qe i pergjigjet nje ushtrimi financiar. Ata mund te ricaktohen.
Shperblimi i kontrolloreve te pavarur caktohet nga Asambleja e shoqerise dhe perballohet nga shoqeria.
Shoqeria ' TREG-TUR-KORÇA' Sh.a, Korce, do te kete nje Ekspert Kontabel . Eksperti i Pare Kontabel i shoqerise caktohet ne kete Statut nga Asambleja e shoqerise.

**Neni 41**
**Detyrat dhe te Drejtat**

Detyrat dhe te Drejtat e kontrolloreve te pavarur te shoqerise jane ato te parashikuara nga Ligji 7638 date 19.11.1992 'Per Shoqerite Tregetare'.
Asmableja e Aksionereve mund t'ju kerkoje kontrolloreve te pavarur kryerjen e kontrolleve apo te verifikimeve te posacme per ceshtje te vecanta ne interes te shoqerise.
Ekspertet Kontabel te Autorizuar thiren ne mbledhjen e Drejtorise qe mbyll llogarite e vitit financiar te mbyllur si edhe ne te gjitha asamblete e aksionereve . Me marjen e raportit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar, Asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqerise.
Raportet qe Ekspertet pergatisin depozitohen ne seline e shoqerise ne afatet e parashikuara nga ligji.

## KAPITULLI 6
## LLOGARITE VJETORE , CAKTIMI I REZULTATIT

**Neni 42**
**Viti Financiar**
Shoqeria pergatit cdo vit financiar llogarite vjetore ne pajtim me ligjin per kontabilitetin. Viti financiar fillon me 01 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

**Neni 43**
**Caktimi i rezultateve**
Rezultati i vitit financiar nxiret dhe caktohet ne pajtim me legjislacionin ne fuqi dhe mbas dhenies se raportit perfundimtar nga Eksperti Kontabel i Autorizuar.

## KAPITULLI 7
## PRISHJA, LIKUJDIMI, KUNDERSHTIMET

### Neni 44

### Prishja, likujdimi

Ne rastin e prishjes se shoqerise nje ose disa likuidatore emerohen nga Asambleja e Pergjithshme e aksionereve ne kushtet e quorimit dhe me shumicen e parashikuar per Asamblete e Pergjithshme te zakonshme. Likujdatori perfaqson shoqerine. Ai ka kopetenca te plota per te realizuar aktivin e shoqerise, te shlyeje kreditoret dhe te shperndaje mbetjen e disponueshme.

Ndarja e aktivit neto qe mbetet pas rimbursimit te nominalit te aksioneve behet midis aksionereve per perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapital.

### Neni 45
### Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Te gjitha mosmarreveshjet gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likujdimit te saj qe lindin midis shoqerise dhe aksionereve ose midis vete aksionereve lidhur me veprimtarine e shoqerise, i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kopetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

## KAPITULLI 8
## EMERIMET E PARA

### Neni 46
### Keshilli Mbikqyres

Si anetare te Keshillit te Pare Mbikqyres emerohen nga aksioneret e shoqerise 'TREG-TUR-KORÇA' Sh.a, Korce per nje kohe prej tre vjetesh personat e meposhtem:

| | |
|---|---|
| 1. Kostandin GJATA | Kryetar i Keshillit Mbikqyres |
| 2.Kristaq GJATA | Zv/kryetar |
| 3.Meleq NANO | Anetar |

te cilet kane bere te ditur qe pranojne funksionet respektive dhe pohojne se nuk jane te prekur nga asnje papajtueshmeri apo ndalim qe pengon emerimin e tyre.

### Neni 47
### Ekspertet Kontabel te Autorizuar

Emerohet si Ekspert Kontabel i Autorizuar i pare per nje kohe prej nje vit financiar Z.Dhimitraq PANO i cili ka bere te ditur qe pranon funksionin e tij dhe pohon se nuk eshte prekur nga asnje papajtueshmeri apo ndalim qe pengon emerimin e tij.

## KAPITULLI 9
## MARREDHENIET E PUNES

**Neni 48**

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me marreveshjen per themelimin e shoqerise, dispozitat e statutit te saj dhe legjislacionin shqiptar te punes.

**Neni 49**

Punesimi ne shoqeri behet sipas kontrates individuale ose kolektive te punes.
Kontrata individuale lidhet per cdo individ ose grup individesh qe nuk bejne pjese ne sindikaten e te punesuarve.
Kontrata kolektive e punes lidhet midis shoqerise dhe sindikates se te punesuarve.

## DISPOZITA TE FUNDIT

**Neni 50**

Padia e ngritur per anullimin e shoqerise ose te akteve te shqyrtuara pas themelimit te saj parashkruhet per 3 vjet, duke filluar nga dita kur vendimi i nullimit ka hyre ne fuqi.

**Neni 51**

Nepunesit e shoqerise si dhe te ngarkuarit me pune prej saj ose nga Asambleja e aksionereve dhe personat e tjere qe punojne per llogari te saj, mbajne pergjegjesi penale kur konstatohet se me dashje shkelin detyrat e ngarkuara qe i shkaktojne humbje shoqerise ose me ndergjegje paraqesin te dhena te paverteta.

**Neni 52**

Mbas nenshkrimit te tij Statuti do te noterizohet dhe hyn ne fuqi mbas rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

**AKSIONERI I SHOQERISE`TREG-TUR-KORÇA` SH.A**
**Kostandin GJATA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA NOTERISE KORCE
NR 2182 REP.

## VERTETIM NENESHKRIMI

Sot me date 24.6.2005(njezete kater qershor dymije e pese ) diten e premte para meje Flora Biba, notere u paraqiten personalisht deklaruesit

1.
2. Kostandin Kico Gjata
3.
4. dt. lindja 1955
5.
6.
7.
8.
9.
10.

Deklaruesit jane madhore te afte per te kryer veprime juridike te njohur prej meje personalisht per idenitetine te cileve u sigurova dhe me dokumentet perkatese te cilet deklaruan se neneshkrimi i vene ne kete dokument eshte i tyre.

PULLE TAKSE
100
LEKE
R.SHQIPERISE

NOTERE

FLORA BIBA

15385

Kerkuesit : 1. Kostandin Gjata,i biri i Kristaqit,dtl.1965,banues ne Korce.
2. Anesti Foto,i biri i Kostas,dtl.1963,banues ne Korce.
3. Sotir Lolo,i biri i Koços,dtl.1950,banues ne Korce.

Objekti : Regjistrimi si person juridik te Shoqerise Tregetare "TREG-TUR-KORCA" Sh P K Korce.

GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

Ne kerkuesit e mesiperm kerkojme regjistrimin si person juridik te Shoqerise Tregetare "TREG-TUR-KORCA" ShPK Korce me tre ortake kerkuesit e mesiperm,me administrator Anesti Foton,me kapital fillestar 100.000 leke,me kohezgjatje mbi 10 vjet,me seli ne Korce tek magazinat e pazarit,me objekt te veprimtarise ne fushen e tregetimit ne shumice e pakice dhe transport te artikujve industriale,ushqimore,fruta-perime, produkte mishi etj.import-eksport.Aktivitet hotelerie dhe turizem.

Mbetem me shprese se kerkesa do te merret parasysh.

KERKUESIT

Kostandin Gjata Anesti Fotot Sotir Lolo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE KORCE
NOTERI M. SIMBLI
Nr 1240 rep 956 kol

**U paguan pulla takse 50 lek ne kopjen e depozituar.**

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me daten 9 Korrik 1996 para meje noterit Mihallaq Simbli i dhomes se notereve Korce u paraqiten shtetasit Kostandin Gjata,Anesti Foto dhe Sotir Lolo,te cilet kane perpiluar kerkesen e mesiperme,te cilet e nenshkruajne ate para meje dhe une noter duke e gjetur ate te rregullt,e nenshkruaj si me poshte.

Noteri
Mihallaq Simbli

15385/1
10/7/1996

KERKESE

Kerkuesi : Anesti Foto,administrator i Shoqerise "TREG-TUR-KORCA" ShPK Korce.

Objekti : Kerkohet depozitimi i akteve per shitjen e kapitalit themeltar te dy ortakeve te shoqerise.
Kerkesa bazohet ne ligjin 7667 date 28.I.1993 dhe ligjin 7638 date 19.11.1992.

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Me vendimin Nr 15385 date 10.7.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar ne regjistrin tregetar Shoqeria Tregetare "TREG-TUR-KORCA" ShPK Korce,me kapital themeltar 100 mije leke,me administrator Anesti Foto,me seli ne qytetin e Korces,me objekt te veprimtarise tregetim me pakice e shumice dhe transport i artikujve industriale,ushqimore,fruta perime,prodhime mishi etj.import eksport.Aktivitet hotelerie dhe turizem.

Ne kete shoqeri me ortake Kostandin Gjata,Anesti Foto dhe Sotir Lolo,sejcili prej tyre perfaqeson nje kapital te barabarte,prej 33,333 leke ose 33,333% te kapitalit themeltar.Me vendimin e dates 1 Shkurt 1997 te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie,ne menyre unanime u vendos shitja e kapitalit themeltar qe perfaqesojne dy ortaket Anesti Foto dhe Sotir Lolo,bleres i te cilit eshte ortaku tjeter i shoqerise Kostandin Gjata.Lidhur me kete vendim te asamblese u perpilua edhe kontrata e shitblerjes e dates 1 Shkurt 1997 per transferimin e kapitalit themeltar si me siper.Ne kete menyre ortaku Kostandin Gjata mbetet ortak i vetem i shoqerise dhe administrator i saj.

Persa me siper,kerkoj nga gjykata depozitimin e akteve te mesiperme,bashkangjitur kesaj kerkese,duke bere ndryshimet e nevojshme ne Regjistrin Tregetar.

Korce me 1 Shkurt 1997

ADMINISTRATORI
Anesti Foto

Te depozitohet
4.02.97

# V E N D I M

Sot me daten 1 Shkurt 1997 ne seline e Shoqerise "TREGTUR-KORCA" ShPK Korce u be mbledhja e asamblese se ortakeve,ku morrnin pjese ortaket :

1- Kostandin Gjata    me kapital themeltar 33,333%
2- Anesti Foto    "    "    "    33,333%
3- Sotir Lolo    "    "    "    33,333%

Mbledhja e asamblese se ortakeve mori ne shqyrtim kete rend dite:

1- Shitja e kapitalit themeltar prej ortakeve Anesti Foto dhe Sotir Lolo.

Mbas diskutimeve,te tre ortaket,qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar rane dakort unanimisht qe ortaket Anesti Foto dhe Sotir Lolo te shesin te gjithe kapitalin e tyre themeltar prej 33,333% secili,ose 33.333 leke ne vlere absolute.Kete kapital te dy ortakeve cfaqi deshiren per ta blere ortaku tjeter i shoqerise Kostandin Gjata. Ne kete menyre ai behet ortak i vetem i shoqerise,dhe administrator.

Ne perfundim te diskutimeve,mbledhja e asamblese se ortakeve

## V E N D O S I

Lejimin e shitjes se kapitalit themeltar prej 33,333 leke ose 33.333% te ortakut Anesti Foto.

Lejimin e shitjes se kapitalit themeltar prej 33,333 leke ose 33,333% te ortakut Sotir Lolo.

Cmimi i shitjes se kapitalit te dy ortakeve eshte i barabarte me vleren e kapitalit themeltar qe shitet.

Te perpilohet kontrata e shitblerjes se kapitalit themeltar midis dy ortakeve qe shesin kapitalin dhe ortakut qe ble kete kapital.

Te behet kerkesa dhe te depozitohen aktet prane regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane,me administrator Kostandin Gjata.

Ndryshimet e mesiperme te behen te njohura edhe ne Degen e Tatimeve te Rrethit Korce.

Korce me 1 Shkurt 1997

Kryetari i asamblese
Sotir Lolo

ORTAKET

Kostandin Gjata    Anesti Foto    Sotir Lolo

## KONTRATE SHITBLERJE

Sot me daten 1 Shkurt 1997 para meje avokat Llambi Qirjila,i dhomes se avokateve Korce u paraqiten :

1- Anesti Foto,i biri i Kostes,datelindja 1963,me banim Rr"Rexhep Telhaj",P.16,Shk. A/8 Korce.

2- Sotir Lolo,i biri i Kocos,datelindja 1955,me banim Rr"Pano Xhaballo",P. 21,Shk. A/6 Korce.

qe paraqiten ne cilesine e shitesit dhe

1- Kostandin Gjata,i biri i Kristaqit,datelindja 1965,me banim Bulevard "Republika",P. 16,Shk. C/6 Korce,

qe paraqitet ne cilesine e bleresit,te cilet kerkuan perpilimin e kesaj kontrate shitblerje per sende te luajtshme me permbajtjen e meposhtme.

Shitesit deklaruan se jane ortake ne Shoqeria "TRLG-TUR-KORCA" ShPK Korce,ne te cilen kane sejcili nga 33,333 leke,ose sejcili nga 33.333% te kapitalit themeltar,gje qe vertetohet me vendimin Nr 15385 date 10.7.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane,me te cilin eshte regjistruar shoqeria ne Regjistrin Tregetar,si dhe aktin e themelimit dhe statutin qe i bashkangjiten ketij vendimi.Ata,me vullnetin e lire e te pa vesuar,deshirojne te shesin kapitalin e tyre themeltar ne kete shoqeri me cmimin qe perfaqeson vete vlera e kapitalit e shprehur ne leke prej 33333 leke sejcili,duke dhene pelqimin qe bleres i ketij kapitali te jete ortaku i trete i kesaj shoqerie Kostandin Gjata.

Nga ana e tij bleresi Kostandin Gjata,deklaron me vullnetin e lire e te pa vesuar,se eshte dakort te blere kapitalin e dy ortakeve te tjere te shoqerise se tyre,qe perbehet 33,333 leke per Sotir Lolon dhe 33,333 leke per Anesti Foton,gjithsej 66,700 leke,dhe eshte dakort me cmimin e shitjes se ketij kapitali,qe perfaqeson vete vleren e tij te shprehur ne leke.Ne kete menyre bleresi Kostandin Gjata behet zoterues i te gjithe kapitalit themeltar te shoqerise "TRLG-TUR-KORCA" ShPK Korce ne masen 100%.

Te dyja palet deklaruan para meje se shuma e lekeve per blerjen e kapitalit eshte paguar prej bleresit tek te dy shitesit,sipas vleftes se kapitalit qe zoteron sejcili prej shitesave.

Kontrata perpilohet ne tre kopje,te cilat do te noterizohen, dhe do te behet regjistrimi i saj ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Kontrata u lexua prej sejciles pale,te cilet jane dakort me permbajtjen e saj dhe mbasi nuk kane verejtje,nenshkruajne ate.

P A L E T

Shitesit

1- Anesti Foto

2- Sotir Lolo

Bleresi

Kostandin Gjata

K E R K E S E

Kerkuesi : Kostandin Gjata, administrator i Shoqerise "TREG-TUR-KORCA" ShPK Korce. NR dep 4151 dt 6/05/1997

15385/2 10/07/1996

Objekti : Kerkohet depozitimi i kerkeses dhe akteve te tjera te shoqerise lidhur me ndryshimin e emrit te shoqerise dhe shitjen e 50% te kapitalit themeltar.
Kerkesa bazohet ne ligjet 7667 date 28.I.1993 dhe 7638 date 19.11.1992.

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Me vendimin Nr 15385 date 10.7.1996 eshte regjistruar prane Regjistrit Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane shoqeria tregetare "TREG-TUR-KORCA"ShPK Korce me tre ortake:Kostandin Gjata,Sotir Lolo dhe Anesti Foto,me administrator Anesti Foto.

Me vendimin Nr 15385/1 date 4.2.1997 eshte depozituar kerkesa e kesaj shoqerie lidhur me shitjen e kapitalit themeltar te ortakeve Anesti Foto dhe Sotir Lolo ortakut tjeter Kostandin Gjata,i cili emerohet administrator i shoqerise dhe mbetet Ortak i Vetem i saj.

Me daten 2 Maj 1997 Ortaku i Vetem i kesaj shoqerie vendos t'i ndryshoje emrin shoqerise,duke e emertuar "Costa Fruit"ShPK Korce,si dhe te shese 50% te kapitalit themeltar me vlere absolute 50 mije lek shtetasit grek Cakuridhis Kostas,i cili ne kete menyre behet edhe ortak ne kete shoqeri.Administrator i shoqerise mbetet Kostandin Gjata.Lidhur me vendimin e shitjes se gjysmes se kapitalit themeltar me daten 4 Maj 1997 u perpilua edhe kontrata e shitblerjes e noterizuar me daten 5 Maj 1997,e cila se bashku me vendimin e Ortakut te Vetem i bashkangjitet kesaj kerkese.

Persa me siper,kerkoj nga Gjykata e Rrethit Tirane,depozitimin e kesaj kerkese e akteve bashkangjitur asaj prane Regjistrit Tregetar.

Mbetem me shprese se kerkesa ime do te pranohet.

Korce me 5 Maj 1997

Administratori
Kostandin Gjata

A V O K A T
ILAMBI QIRILLA
K O R Ç E

KONTRATE SHITBLERJE

Sot me daten 4 Maj 1997 para meje avokatit Llambi Qirilla i dhomes se avokateve Korce u paraqiten:

1- Kostandin Gjata,i biri i Kristaqit,datelindja 1965,me banim Bulevard "Republika", P.16, Shk.C/6 Korce,ne cilesine e shitesit dhe

2- Cakuridhis Kostas,i biri i Stavros,datelindja 1937,me shtetesi greke,me Nr pashaporte L466915,me banim Veria-Greqi,ne cilesine e bleresit,

te cilet kerkuan perpilimin e kesaj kontrate shitblerje per sende te luajtshme,me permbajtjen e meposhtme:

Shitesi eshte ortak i vetem i shoqerise tregetare "Treg-Tur-Korce"ShPK Korce,e cila eshte e regjistruar prane regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane me Nr 15385 vendimi,date 10.7.1996, i ndryshuar me vendimin Nr 15385/1 date 4.02.1997,dhe zhvillon aktivitetin ne fushen e tregtetise,duke pasur nje kapital themeltar prej 100 mije leke.

Me vullnetin e tij te lire e te pa vesuar,ai deklaron se kerkon te shese gjysmen e ketij kapitali,ne vleren 50 mije leke dhe me po kete vlere,shtetasit grek Tsachooridis(Cakuridhis) Kostas,duke pranuar ne kete menyre qe shtetasi grek te behet ortak i shoqerise "Treg-Tur-Korce",emerin te cilin shitesi e ka ndryshuar me vendimin e tij te dates 2 Maj 1997,duke e emeruar shoqerine "Costa Fruit".

Nga ana e tij bleresi Cakuridhis Kostas,me vullnetin e tij te lire e te pa vesuar,deklaron se eshte dakort te bleje 50% te kapitalit themeltar prej 50 mije lekesh te shoqerise tregetare "Treg-Tur-Korce" me emrin e ndryshuar "Costa Fruit",duke i paguar shitesit te njejten vlere te barabarte me vleften e kapitalit.

Te dy palet deklaruan para meje se vlefta prej 50 mije leke eshte paguar prej bleresit tek shitesi para hartimit te kesaj kontrat

Kjo kontrate u perpilua ne kater kopje te njejta,te cilat do te noterizohen dhe nje prej tyre do te paraqitet prane Gjykates se Rrethit Tirane per veprim.

Permbajtja e kontrates u lexua,palet jane dakort me permbajtjen e saj dhe nenshkruajne.

P A L E T

Shitesi
Kostandin Gjata

Bleresi
Cakuridhis Kostas

A V O K A T
ILAMBI QIRILLA
K O R Ç E

Perkthyesi
Vladimir Cepa

V E N D I M

Sot me daten 2 Maj 1997 ne seline e Shoqerise "Treg-Tur-Korca" ShPK Korce, Ortaku i vetem i shoqerise Kostandin Gjata mori ne shqyrtim dy ceshtje te rendit te dites:

1- Ndryshimi i emrit te shoqerise tregetare ne "Kosta Fruit" ShPK Korce.

2- Shitja e gjysmes se kapitalit themeltar te shoqerise shtetasit grek Tsachooridis Kostas.

Lidhur me ceshtjen e pare te rendit te dites, ortaku i vetem pranon ndryshimin e emertimit te shoqerise per shkak se emertimi i pare ishte vendosur ne kohen kur shoqeria kishte tre ortake. Me vendimin Nr 15385/1 date 4.02.1997 te Gjykates se Rrethit Tirane, ortaku i vetem bleu gjithe kapitalet e shoqerise qhe ne keto kushte ai do t'ja pershtase emrin e shoqerise emrit te tij qhe te ortakut qe mendon te bashkepunoje.

Lidhur me ceshtjen e dyte te rendit te dites, Ortaku i vetem eshte dakort qe gjysmen e kapitalit themeltar qe kap shumen absolute prej 50 mije leke, t'ja shese bleresit grek Tsachooridis Kostas, i cili i ka propozuar kete blerje.

Perfundimisht si ortak i vetem :

V E N D O S A

1. Ndryshimin e emertimit te shoqerise "TREG-TUR-KORCA"ShPK Korce, ne emertimin Shoqeria "Costa Fruit" Shpk Korce.

2. Shitjen e 50% te kapitalit themeltar te shoqerise ne shumen prej 50 mije leke bleresit me shtetesi greke Tsachooridis Kostas, duke e pranuar ate si ortak te shoqerise.

3. Administrator i shoqerise do te jete perseri Kostandin Gjata

4. Te perpilohen dokumentat e nevojshme per ndryshimet, te cilat te depozitohen ne regjistrin tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane si qhe te behen te njohura ne Degen e Tatimeve te Rrethit.

ORTAKU I VETEM
Kostandin Gjata

15385/3

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ASAMBLEA ORTAKEVE TE SHOQERISE
"COSTA FRUIT" SHPK Korce

G A Xharhaj
07.01.2002

# K E R K E S E

GJYKATES RRETHIT

T I R A N E

Asamblea e Ortakeve e Shoqerise Costa Fuit SHPK Korce e mbledhur me daten 20.12.2001 ka vendosur ndryshimin e kapitalit nga Ortaku Cakuridhis Kistas tek ortaku tjeter Kostatin Gjata duke i shitur atij 50 % te kapitalit dhe mbas kesaj shitje ortak i vetem behet Kostandin Gjata me vlere te kapitalit 100 %.

Gjithashtu eshte miratuar edhe ndryshimi i emertimit te Shoqerise nga ~~TREGxTURxKORC~~A kosta frut ne TREG TUR KORCA SHPK Korce.

Pra nga ana e kesaj jykate kerkoj rregjistrimin prane regjistrit tregetare te vendimit te mesiperm te asamblese se ortakeve te Shoqerise Treg Tur Korca SHPK.

KERKUESI
KOSTANDIN GJATA
ADMINSITRATOR I SHOQERISE TREG TUR KORCA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE KORCE
NR!888888 9824 Rep.
Nr. ——— Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me daten 27.12.2001(Njezet e shtate Dhjetor Dymije e nje) diten e ENJTE,para meje ZHULIETA ILIA MANO,me detyren e noteres u paraqiten personalisht kerkuesi para Zyres Noterise te ndodhur ne qytetin e Korces ne Rr.28 Nendori,Ngjitur me Gjykaten e Rrethit Korce,

KERKUES: KOSTANDIN GJATA,i biri i Kristaqit,me datlindje 1965 banues ne Korce me Nr.664011 patente ,Administrator i Shoqerise iTreg Tur Korca SHPK,madhor,i afte per te kryer veprime juridike,i njohur prej meje personalisht,i cili deklaroi se eshte plotesisht dakord me kerkesen e mesiperme dhe se firma e vene ne te eshte e tij.

N O T E R E
ZHULIETA ILIA MANO

PULLE TAKSE
50 LEKE
R.SHQIPERISE

NOTERE KORÇE
ZHULIETA

KËRKESË

KËRKUES: Kostandin Gjata, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë "Costa Fruit" Sh.p.k., Korçë.

OBJEKTI: Depozitimi i Vendimit të Asamblesë së Ortakëve datë 24 dhjetor 2001.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 7667 datë 28. 01. 1993 "Për regjistrimin e shoqërive në regjistrin tregtar"

GJYKATËS SË RRETHIT
TIRANË

Me vendim nr. 15385 datë 10. 07. 1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Shoqëria "Treg-Tur-Korçë" Sh.p.k. është regjistruar si person juridik me seli në Korçë, me ortakë Kostandin Gjata, Anesti Foto dhe Sotir Lolo, me administrator Kostandin Gjata, për të ushtruar aktivitetin e vet privat sipas objektit të veprimtarisë së vendosur në statutin e shoqërisë. Me vendimin nr. 15385/1 datë 04. 02. 1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë është depozituar vendimi i Asamblesë së ortakëve për largimi e dy ortakëve Anesti Foto dhe Sotir Lolo dhe mbetja e shoqërisë me ortak të vetëm Zotin Kostandin Gjata. Me vendimin nr, 15385/2 datë 06. 05. 1997 të ortakut të vetëm është vendosur ndryshimi i emrit të Shoqërisë në "Costa Fruit" Sh.p.k. dhe pranimi i ortakut të ri Cakuridhis Kostas.

Me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë datë 24 dhjetor 2001 është vendosur:

1. Largimi i ortakut Cakuridhis Kostas dhe shitja e 50% të kuotave të kapitalit të zotëruara prej tij dhe blerja e tyre nga ortaku që mbetet i vetëm Kostandin GJATA, duke hartuar dhe kontratën e shitjes së kuotave.

2. Ndryshimi i emrit të shoqërisë nga "COSTA FRUIT" Sh.p.k. në emërtimin e ri "TREG-TUR-KORÇA" Sh.p.k.

Kërkoj nga kjo gjykatë që të depozitohet vendimi i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë datë 24 dhjetor 2001, duke urdhëruar Zyrën e Regjistrit të Shoqërive për të pasqyruar ndryshimet e mësipërme në librin e shoqërive.

Bashkëngjitur dokumentat përkatëse.

KËRKUESI
Kostandin GJATA

Kostandin Gjata

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ASAMBLEJA ÐRTAKEVE TE SHOQERISE

COStA FRUIT SHPK KORCE

# V e N D I M

Asambleja e ortakeve te sho erise Costa Fruit SHPK Korce e mbledhur me date 24 dhjetor 2001 ne seline e saj ne qytetin Korces mori ne shqyrtim kete rend dite -

1. Kerkesen e ortakut Cakuridhis Kostas me shitjen e 50% te kuotave te kapitalit qe ka ne kete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shumen rej 50.000 lek.

2. Ndryshimin e emertimit te shoqerise tregetare nga KOSTA FRUT SHPK ne Tregt tur KORCE SHPK

Pas shqyrtimi e tshitjepimit te kuotave te kapitalit te probleme te siperme , asambleja e ortakeve

# V E N D O s i

1. Miratimin e shitjes te kuotave te kapitalit te ortakut Cakuridhis Kostas tek ortaku tjeter Kostandin Gjata pikerisht 50% te kapitalit.

2. Ortaku i vetem ne shoqeri mbetet vetem KOSTANDIN GJATA i cili zoteron mbas kesaj mblejdhej dhe perpilimit te kontrates shitjes 100% te kapitalit.

3, Miraton ndryshimin e emertimit te kesaj shoqerie nga COSTRA FRIUT KORCA SHPK ne TREG TUR KORCA SHPK KORçe.

4. Ngarkohet administrqtor i kesaj shoqerie Treg tur Korca te depozitoje kerkesen prane gjykates rrethit Tirane .

Korce me 20.12.2001

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

KOSTANDIN GJATA

Kostandin Gjata

CakurIDHIS KOSTAS

perkthyesi ASTRIT QANI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA NOTERISE KORCE
Nr. 104 rep
nr. 85 kol.

KONTRATE SHIT BLERJE
KUOTAVE TE KAPITALIT

Sot me date 20.1.2002(njezet janar dymije e dy ) diten diele, para meje Flora Shuaip Biba, notere u paraqiten personalisht palet :

SHITES: CaKURIDHIS KOSTAS i biri i Stavros dat.lindja 1937 me nr. pasaporte L466915, shtetas grek banues ne Veria Greqi

BLERES : KOSTANDIN GJATA i biri i Kristaqit dat.lindja 1965 banues ne Korce, me nr. pasaporte 1382866

Te dy palet jane madhore te afte per te kryer veprime juridike te pa njohur prej meje per idenitetin e te cileve u sigurova me dokumentet perkatese te cilet kerkuan redaktimin e ketij akti si vijon :

Me qene se Cakuridhis Kostas eshte shtetas Grek, pavaresisht se me te mund te komunikosh u paraqitu dhe perkthyesi Z. Astrit Qaniu i sicili deklaroi se do te perktheje kete dokument testatualisht sic eshte teksi i kontrates, kontrate e cila do te perpilohet ne gjuhe shqipe.

Shitesi Cakuridhis Kostas ne baze te kontrate shit blerjes me nr.362 rep. dhe 262 Kol date 5 maj 1997 redaktuar para noterit Mihallaq Bumbli ne Korce dhe rregjistruar ne gjykaten e rrethit Tirane me vendimin nr. 15385/2 date 6.5.1997 eshte bere bashkepronar ne shoqerine COSTA FRUIT KORCA SHPK me 50% te kapitalit me nje vlere prej 50.000(pesedhjetmije ) lek . Me vullnetin e lire e te plote ai deklaron se kuotat e tij ne kete shoqeri pikerisht 50% te saj ja shet bashkeortakut tjeter KOstandin Gjata .

Kete fakt e ben mbasi ka mare dhe perlqimin e miratimin ne mbledhjen e ortakeve me vendimin date 24 dhjetor 2001.

Nga ana e tij KOstandin Gjata deklaroj se eshte dakort ne blerjen e kuotave te bashkeortakut CAKURIDHIS GJATA pikerisht 50% te tij dhe mbas kesaj blerje mbetet ortak i vetem ne shoqerise COSTA FRUIT KORCA SHPK mbas kesaj kontrate shit blerje.

Palet deklaron se mbas perpilimit te kesaj kontrate

mbetet qe kjo kontrate te rregjistrohet dhe ne gjykaten e Tiranes .

Sa siper lexohet kjo kontrate shitje kapitali e cila ju perkthye dhe ne gjuhen Greke Z. CAKURIDHIS KOSTAS dhe palet ishin dakort me permbajtjen e te ciles palet jane dakort e neneshkruan rregullisht ketu para meje, shitesi, bleresi dhe perkthyesi Astrit Qaniut.

SHITESI

CAKURIDHIS KOSTAS

BLERESI

KOSTANDIN GJATA

PERKTHYESI

ASTRIT Qaniut

REPUBLIKA E SHQIPERISE FLORA SH BIBA NOTERE KORÇE

N O T E R E

Flora BIBA

15385/4
25.01.2002

3 Madopgo
25.01.2002

Korçe, me ________ KERKESE

**KERKUESI : Kostandin GJATA** administrator I Shoqerise "TRG-TUR-KORÇA" Sh. p. k. Korçe.

**OBJEKTI I KERKESES :** Pranimin e Vendimit te Asamblese se ortakut te shoqerise per emerimin e Ekspertit te Kontributeve per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise me ane te kontributeve ne natyre, konforme nenit 63 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

**GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE**

Me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane nr. 15385 dt. 10. 7.1996 eshte regjistruar shoqeria "TREG-TUR-KORÇE" sh.p.k. Korçe me ortak Z. Kostandin GJATA, Anesti FOTOdhe Sotir LOLO me seli ne magazinat e pazarit dhe kapital themeltar 100000 lek me aktivitet eksport import fruta- perime..Me vendimin E Gjykates te rrethit Tirane Nr. 15385/1 dt. 4.2.1997 kjo shoqeri sipas aktit te shitjes te dt. 1.2.1997 eshte vendosur te kete nje ortak te vetem Z. Kostandin GJATA me kapital themeltar 100000 lek. Me vendimin e Gjykates te rrethit Tirane Nr. 15385/2 dt. 6.5.1997 eshte vendosur qe kjo shoqeri te quhet "COSTA FRUIT" sh. p.k. Korçe si dhe lejimin e shitjes se 50% se kapitalit themeltar te Z. CAKURIDHIS Kostas. Me vendim te Gjykates te Rrethit Tirane Nr. 15385/3 ____ sipas aktit te shitjes nr. 3822 dt 25. 1. 2002 27.12.2001te pjeses 50% te kapitalit themeltar Z. Kostandin GJATA kjo shoqeri sipas vendimit te asamblese te dt. 20.12.2001 ka ortak te vetem Z. Kostandin GJATA dhe emerimi I shoqerise do te jete "TREG-TUR-KORÇE" sh.p.k. Korçe. Aktiviteti I kesaj shoqerie eshte import-eksport artikuj ushqimore, fruta perime, hoteleri, turizem, transport, prodhime industriale.Me vendimin e asamblese se shoqerise nr. bashkengjitur kesaj kerkese mbas diskutimit per analizen financiare te shoqerise si dhe duke u mbeshtetur mbi ivestimet qe jane kryer eshte vendosur te fillojne procedurat ligjore per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise me ane te kontributeve ne natyre. Per kete ne mbeshtetje te nenit 63 te ligjit nr. 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" per vleresimin e kontributeve ne natyre, ne cilesine e ekspertit te kontributeve eshte vendosur Z. Dhimiter PANO I cili eshte edhe ekspert konabel I shoqerise me mandat 6 vjeçar.

Bashkengjitur ju percjellim vendimin e Asamblese se shoqerise nr.2 dt.

ONL 4
dt 24.1.2002

**KERKUESI**
**ADMINISTRATORI I SHOQERISE**
(Kostandin GJATA)

TREG TUR KORÇA
IMP. EKS. FRUTA PERIME
TEL. FAKS 355 824 3815
KORÇA ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA
Nr. 167 rep.

VERTETIM

Sot me date 24.1. 2002, u paraqiten perpara meje noterit VASIL FYPE, personalisht Z. Kostandin GJATA per identitetin e te cilit u njoha nepermjet dokumentit te identifikimit , I cili me deklaroi se jashte kesaj zyre eshte pergatitur Vendimi I Asamblese se shoqerise, te cilin e nenshkruan me vullnet te lire para meje, te cilin une e vertetoj sipas ligjit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER VASIL FYPE
TIRANE

PULLE TAKSE 50 LEKE
RSHQIPERISE

Noteri
NOTER
( VASIL FYPE )
TIRANE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**ASAMBLEJA E ORTAKUT**
**TE SHOQERISE "TREG-TUR KORÇE", Sh.p. k.**
**KORÇE**

**VENDIM Nr. 4**

Mbeshtetur mbi analizen e treguesve financiare te shoqerive qe kam krijuar dhe kam ne administrim, ne baze te vendimit te gjykates Tirane Nr. 15385 shoqeria eshte regjistruar me kapital themeltar 100000 lek. Gjate ketyre viteve kjo shoqeri ka kryer investime ne natyre ne vlere mbi 130000000 lek , per te cilat mbas diskutimit lindi nevoja per zmadhimin e kapitalit te shoqerise. Per kete :

**VENDOSI**

1. Te fillojne proçedurat per zmadhimin e kapitalit te shoqerise, duke bere vleresimin sipas kerkesave ligjore per kapitalet ne natyre te krijuara gjate viteve, kerkese konfort nenit 42 te ligjit 7638 dt. 19.12.1992 "Per shoqeri tregetare."
2. Per efekt te zmadhimit te kapitaleve te shoqerise ngarkojme me mission ligjor te shprehet per kete qellim Z. Dhimiter PANO ekspert kontabel I autorizuar, I cili ka dhe mareveshjen e mandatin e emeruar per 6 vite nga kjo shoqeri.
3. Dega e finances, te vere ne dispozicion te ekspertit kontabel te autorizuar dokumentacionon e kerkuar sipas bilancit, investimet e kryera, inventaret e Aktiveve te qendrueshme, vleresimet e kryera etj, mbi bazen e te cilave ai do paraqese para asamblese Raportin e ekspertit kontabel te autorizuar per Zmadhimin e kapitalit themeltar.
4. Mbas miratimit perkates ligjor te ndiqen procedurat ligjore e juridike per depozitimet e tyre ne Gjykaten e regjistrit prane Gjykates Se Rrethit Tirane brenda muajit
5. Shpenzimet per ekspertin e avokatin sipas kontrates e fatures do behen nga ana e shoqerise.

**ASAMBLEA E ORTAKUT TE SHOQERISE "TREG-TUR KORÇE" Sh. p. k. KORÇE**
**Kostandin GJATA**

TREG-TUR KORÇA
... FRUTA PERIME
TEL/FAKS +355 824 3815
KORÇA ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA
Nr. 168 rep.

VERTETIM

Sot me date 24.1.200[illegible], u paraqiten perpara meje noter VASIL FYPE, personalisht Z. Kostandin GJATA per identitetin e te cilit u njoha nepermjet dokumentit te identifikimit , i cili me deklaroi se jashte kesaj zyre eshte pergatitur Vendimi I Asamblese se shoqerise, te cilin e nenshkroi me vullnet te lire para meje, te cilin une e vertetoj sipas ligjit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
VASIL ... NOTER

TAKSE
50 LEKE
SHQIPERISE

Noter

NOTER
VASIL FYPE
TIRANE

15385/5

30.01.2002

Korçe, me 27.1.2002.  KERKESE

**KERKUESI : Kostandin GJATA** administrator I Shoqerise "TRG-TUR-KORÇA" Sh. p. k. Korçe.

**OBJEKTI I KERKESES :** Pranimin e Vendimit te Asamblese se ortakut te shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise me ane te kontributeve ne natyre, konforme nenit 63 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

**GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR**
**TIRANE**

Me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane nr. 15385 dt. 10. 7.1996 eshte regjistruar shoqeria "TREG-TUR-KORÇE" sh.p.k. Korçe me ortak Z. Kostandin GJATA, Anesti FOTOdhe Sotir LOLO me seli ne magazinat e pazarit dhe kapital themeltar 100000 lek me aktivitet eksport import fruta- perime..Me vendimin Egjykates te rrethit Tirane Nr. 15385/1 dt. 4.2.1997 kjo shoqeri sipas aktit te shitjes te dt. 1.2.1997 eshte vendosur te kete nje ortak te vetem Z. Kostandin GJATA me kapital themeltar 100000 lek. Me vendimin e Gjykates te rrethit Tirane Nr. 15385/2 dt. 6.5.1997 eshte vendosur qe kjo shoqeri te quhet "COSTA FRUIT" sh. p.k. Korçe si dhe lejimin e shitjes se 50% se kapitalit themeltar te Z. CAKURIDHIS Kostas. Me vendim te Gjykates te Rrethit Tirane Nr. 15385/3 sipas aktit te shitjes nr. 3822 dt. 27.12.2001te pjeses 50% te kapitalit themeltar Z. Kostandin GJATA kjo shoqeri sipas vendimit te asamblese te dt. 20.12.2001 ka ortak te vetem Z. Kostandin GJATA dhe emerimi I shoqerise do te jete "TREG-TUR-KORÇE" sh.p.k. Korçe. Aktiviteti I kesaj shoqerie eshte import-eksport artikuj ushqimore, fruta perime, hoteleri, turizem, transport, prodhime industriale.Me vendimin e Gjykates nr.15385/4 dt.25.1.02 sipas vendimit nr. 4 dt.24.1. Per vleresimin e kontributeve ne natyre te shoqerise ne cilesine e ekspertit te kontributeve eshte vendosur Z. Dhimiter PANO I cili eshte dhe ekspert kontabel I shoqerise me mandat 6 vjecar per kontroolin ligjor te llogarive te shoqerise. Me raportin e ekspertit Dhimiter PANO per vleresimin e kontributeve ne natyre dt26.0102 Sipas iventarit te vecante te active te qendrueshme te trupezuara si ndertesa, paisje, mjete transporti e.t.j. te investuara gjate kesaj periudhe aktiviteti te shoqerise, I cili u diskutua, dhe me vendimin e asamblese nr. 5 u vendos te behet zmadhimi I kapitalit themeltar te shoqerise me ane te kontributeve ne natyre per shumen 133 984 854 lek qe se bashku me pjesen prej 100 000 lek te derdhur per themelin e shoqerise arin ne shumen 134 084 854 lek.

Bashengjitur ju percjellim vendimin e asamblese te ortakut themelues te shoqerise nr5 dt24.01 Si dhe raportin e ekspertit kontabel te autorizuar dt. 26.1.2002.

**KERKUESI**
**ADMINISTRATORI I SHOQERISE**
(Kostandin GJATA)

TREG TUR KORÇA
IMP. EKS. FRUTA PERIME
TEL. FAKS 355 824 ...
KORÇA ALBAN

Z. M. Dogga
28.01.2002
28 GEN 2000

Te depozitohet kerkesa, Vendim sot dt 27.1.2002, ... Vleresim i ekspertit 3 flete Nr. 171 dt 26.1.2002. ... 30.1.2002

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"Treg – Tur Korce" SH.P.K. KORÇË

**VENDIM**

Nr. 5 DATE 27.1.2002.

Sot me daten 27.1.02 ne seline e shoqerise "Treg – Tur Korce" Sh.P.K Korce asambleja e kesaj shoqerie e perbere nga Kostandin Gjata morri ne shqyrtim kete rend dite:

Miratimin e raportit te ekspertit per kontributet Z. Dhimiter Pano te dates 26.1.02 lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet kontributit ne natyre.

1. Mbas shqyrtimit te ketij raporti sipas te cilit vlera e kontributit ne natyre qe perben zmadhimin e kapitalit themeltar eshte 133 984 854 Leke e ndare sipas zerave toka, ndertesa, instalime, mjete transporti dhe paisje inventare, te cilen e miratojne plotesisht ate. Shtuar vleren prej 100 000 leke te kapitalit themeltar te derdhur per themelimin e shoqerise, vlera e kapitalit themeltar te shoqerise arin ne shumen 134 084 854 leke.
2. Neni 2 i aktit te themelimit ndryshon si vijon: Vlera e kapitalit themeltar do te jete prej 134 084 854 leke dhe me ortak te vetem Z. Kostandin Gjata.

**Persa me siper**

Ne baze te nenit 7 te statutit dhe neneve 42 dhe 63 te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare" .

**VENDOSEM:**

1. Miratimin e raportit te ekspertit per kontributet te dates 26.1.02 lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren 133 984 854 leke, nepermjet kontributit ne natyre sipas zerave te evidentuara ne pasqyren bashkangjitur raportit. Kesaj vlere te kapitalit i shtohet vlera prej 100 000 leke e derdhur per themelimin e shoqerise dhe gjithsej vlera arin ne shumen 134 084 854 leke.

2. Neni 2 i akt themelimit ndryshon si vijon: Vlera e kapitalit themeltar do te jete prej 134 084 854 leke dhe me ortak te vetem Z. Kostandin Gjata.

3. Te depozitohen aktet e ndryshimit te statutit per zmadhimin e kapitalit ne regjistrin themeltar.

**Ortaku i shoqerise Treg – Tur Korca**

**Kostandin Gjata**

TREG TUR KORÇA
IMP. EKS. FRUTA PERIME
TEL. FAX. ++355 824 3815
KORÇA ALBANIA

# RAPORT

## PER VLERESIMIN E KONTRIBUTIT NE NATYRE TE SHOQERISE " TREG – TUR KORCA " SH.P.K

## KORÇË

**Ansamblesë të Shoqërisë " TREG – TUR KORCA "**

**Zotëri I nderuar!**

Në ekzekutim të misionit që më është besuar nga ana juaj, kam nderin t'iu paraqes Raportin tim që ka të bëjë me vlerësimin e kontributit në natyrë, e cila do të formojë kapitalin themeltar të Shoqërisë suaj.

Për vlerësimin e kontributit në natyrë u mbështeta:

Në ligjin Nr. 7638 datë 19.11.2001 " Për shoqëritë tregëtare" dhe konkretisht në nenet 42 dhe 85 të tij, ku si Ekspert kontabël i autorizuar më jep të drejtën të ndërhyj në vlerësimin e kontributeve në natyrë.

Në mbështetje të Ligjit më sipër, verifikova kontributet në natyrë dhe pasi i vlerësova, ato rezultojnë si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Toka | 11 011 000 Leke |
| 2. | Ndërtesa | 104 886 000 Lekë |
| 3. | Instalime dhe paisje | 3 415 554 Lekë |
| 4. | Mjete transporti | 14 672 300 Lekë |
| | **Shuma** | 133 984 854 Lekë |

Amortizimi per vitet 1999-2000 i përdorimit të tyre deri në 31.12.2000 4 237 358 leke

Për vlerësimin e kontributeve në natyrë proçedurat janë përcaktur:

1. Në Planin kontabël të përgjithshëm të Miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 334 datë 09.07.1993.
2. Në Ligjin për Kontabilitetin Nr. 7661 datë 19.01.1993 dhe konkretisht në nenet 59 dhe 60.

Për vlerësimin e kontributeve në natyrë gjeta dekumentacionin e nevojshëm si Kontrata të shitblerjeve për tokën, gent planin e vendosjes, situacionet e vlerave ndërtimore të fabrikës, deklaratat doganore të importit, fletë hyrjet dhe fletë daljet e rregullta, si dhe

gjithë inventarizimin evjetor 2000 të makineri pajisjeve për fabrikën, këto të kontabilizuara në Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në librat e llogarisë të shoqërisë.

Në vlerësimin e kontributeve në natyrë kemi mbajtur parasysh proçedurat mbi invevtarizimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara sipas strukturës të tyre. Ndërtesa përbëhen nga zyrat, dyqanet e magazinat, të cilat janë dhe objekti kryesor. Mjetet e transportit e paisjet sherbejne per aktivitetin kryesor te kesaj shoqerie e cila eshte eksport – inport fruta perime, hoteleri turizem. Me poshte po paraqesim inventarin e ketyre aktiveve sipas strukturave perkatese.

**INVENTARI FIZIK I A.K.Q. TE TRUPEZUARA DATE**

| Nr | Emertimi i aktivit | Koha e formimit Aktivit Q. Tr Nr. Dekl. Dog.& data | Njesia e matjes | **Sasia** | Çmimi | Vlera totale Kontabile |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **TOKA** | **Akt vleresimi dt. 20.09.01** | | | | | **11 011 000** |
| **NDERTESA** | | | | | | **104 886 000** |
| 1. | Hoteli | Akt vleresimi 20.09.01 | cope | 1 | 92 216 000 | 92 216 000 |
| 2. | Frigoriferi | Akt vleresimi 20.09.01 | cope | 1 | 12 670 000 | 12 670 000 |
| **INSTALIME dhe PAISJE** | | | | | | **3 415 554** |
| 1. | Makina qepese | Fature 30.11.1998 | cope | 32 | 63 753 | 2 040 104 |
| 2. | Peshore | Fature 30.11.1998 | cope | 1 | 20 000 | 20 000 |
| 3. | Tavoline | Fature 4.12.1998 | cope | 3 | 3 500 | 10 500 |
| 4. | Kalkulator | Fature 4 12. 1998 | cope | 3 | 2 100 | 6 300 |
| 5. | Kabine | Akt. Vleresi 22.10.01 | cope | 1 | 1 338 650 | 1 338 650 |
| **MJETE TRANSPORTI** | | | | | | **14 672 300** |
| 1. | Makine volvo | Kontrate 1998 | cope | 1 | 2 500 000 | 2 500 000 |
| 2. | Benc | Kontrate 1998 | cope | 1 | 4 384 800 | 4 384 800 |
| 3. | Skania | Kontrate 1998 | cope | 1 | 3 809 500 | 3 809 500 |
| 4. | Benc | Kontrate 1999 | cope | 1 | 3 000 000 | 3 000 000 |
| 5. | Man | Kontrate 2000 | cope | 1 | 975 000 | 975 000 |
| **Shuma totale** | | | | | | **133 984 854** |

Pra sa pershkova me siper te gjitha keto objekte ne natyre, te inventarizuara ne emer dhe per llogari te shoqerise jane Aktive te qendrueshme te trupezuara dhe qe formijne Kontributet ne natyre te investuara nga shoqeria dhe qe perbejne edhe vlere per kapitalin themeltar te shoqerise "Treg – Tur Korce " SH.P.K. Korçë. Per madhesine se per cfare vlere do te behet ky zmadhim kapitali do te shprehet asambleja e ortakeve te shoqerise. Ky raport u plotesua ne dy kopje te barabarta nga te cilat nje kopje i jepet Asamblese se shoqerise dhe tjetra mbahet nga Eksperti kontabel i autorizuar.

**EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR**

**DHIMITER PANO**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE**
**Nr. 177 rep.**

**VERTETIM**

Sot me date 26.1.2002 u paraqit perpara meje noterit personalisht Z. Dhimiter Pano i njohur prej meje me Detyren e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, i cili pasi deklaroi se ka perpiluar Raportin e vleresimit te kapitaleve ne natyre te Shoqerise " Treg – Tur Korce" Sh.P.K te cili e nenshkroi me vullnet te lire, para meje dhe kerkoj noterizimin e tij. Meqenese prej meje nuk shihet ndonje pengese ligjore vertetoj sa me suiper dhe noterizoi.

**Noteri.**

NOTER
VASIL FYPE
TIRANE

15335/6

Korce me 10 maj 2003

KERKESE

**KERKUESI : Kostandin GJATA** administrator i shoqerise " Treg Tur korca " SH.P.K Korce

**OBJEKTI I KERKESES :** Pranimin e Vendimit te Asamblese se ortakut te shoqerise per emerimin e Ekspertit te Kontributeve per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise me ane te kontributeve ne natyre,konform nenit 63 te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

**GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE**

